

LIGJ PËR MENAXHIM ME BATERI DHE AKUMULATORË DHE BATERI DHE AKUMULATORË TË HEDHUR

TEKST I KONSOLIDUAR ¹

**Teksti në
gjuhën
Maqedonase**
Закон за
управување со
батери и
акумулатори и
отпадни батери и
акумулатори

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Lënda e rregullimit

Me këtë ligj rregullohen kërkesat për mbrojtjen e mjedisit jetësor të cilat doemos duhet t'i plotësojnë bateritë dhe akumulatorët gjatë prodhimit të tyre dhe lëshimit në treg në Republikën e Maqedonisë dhe veprimi me bateritë dhe akumulatorët e hedhur, që i përfshin obligimet dhe përgjegjësitë e operatorëve ekonomikë dhe subjekteve tjera që marrin pjesë në procesin e prodhimit dhe lëshimit në treg të baterive dhe akumulatorëve, kufizimi i përdorimit të baterive dhe akumulatorëve që përmbajnë substanca të rrezikshme, rregullat për grumbullim, përpunim, riciklim dhe mënjanim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur, si dhe kushtet tjera për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur, njoftimi dhe instrumentet ekonomike për arritjen e qëllimeve nacionale për grumbullimin dhe përpunimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur.

Neni 2

Zbatimi subsidiar i ligjeve tjera

(1) Për çështjet që lidhen me rregullat për menaxhim dhe veprim me hedhurina të rrezikshme, do të zbatohen dispozitat e Ligjit për menaxhim me hedhurina, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(2) Për rregullimin e çështjeve lidhur me: qasjen në informatat të cilat kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, pjesëmarrjen e publikut në marrjen e vendimeve, vlerësimin e ndikimit të strategjive të caktuara, planet dhe programet mbi mjedisin jetësor, vlerësimin e ndikimeve të projekteve të caktuara mbi mjedisin jetësor, zbatohen dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(3) Në procedurat e përcaktuara me këtë ligj zbatohet Ligji për procedurën e përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 3

Qëllimet e ligjit

(1) Qëllimi kryesor i këtij ligji është zvogëlimi i nivelit më të vogël të mundshëm të ndikimit negativ të baterive dhe akumulatorëve dhe të baterive dhe akumulatorëve të hedhur mbi mjedisin jetësor, me çfarë

kontribuohet për mbrojtjen, ruajtjen dhe avancimin e gjendjes në mjedisin jetësor.

(2) Qëllimi i veçantë i ligjit është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit jetësor nëpërmjet përmirësimit të karakteristikave ekologjike të baterive dhe akumulatorëve gjatë ciklit jetësor të përgjithshëm të tyre dhe ndalimi i përdorimit të substancave të rrezikshme dhe kufizimi i përmbajtjes së tyre në bateritë dhe akumulatorët në raste kur nuk ekzistojnë alternativa përkatëse.

(3) Duke pasur parasysh ndikimin e transportit mbi mjedisin jetësor, ky ligj ka për qëllim që të arrijë shkallë të lartë të grumbullimit të veçantë të baterive dhe akumulatorëve të hedhur dhe ta zvogëlojë në masën më të madhe të mundshme, mënjanimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur si pjesë të hedhurinave të komunaleve me qëllim të arrihet nivel i lartë i përpunimit të tyre.

(4) Krahas qëllimeve nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, në pajtim me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm me këtë ligj arrihen edhe qëllimet në vijim:

- zvogëlimi i sasisë së baterive dhe akumulatorëve të hedhur që mënjanohehen në deponi,
- arritja e nivelit të lartë të grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur,
- arritja e nivelit të lartë të riciklimit dhe të llojeve tjera të përpunimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur,
- sigurimi i kushteve për themelimin e sistemit për veprim (kthim, grumbullim, përpunim dhe riciklim) të baterive dhe akumulatorëve të hedhur,
- sigurimi i kushteve për themelimin dhe zhvillimin e tregut për përpunim dhe riciklim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur dhe
- sigurimi i pozitës së barabartë në treg ndërmjet personave fizikë dhe juridikë të vendit dhe të huaj, si dhe të shmangen dhe mënjanohehen barrierat tregtare që mund ta prishin tregun.

Neni 4

Zbatimi i ligjit

(1) Dispozitat e këtij ligji zbatohen për bateritë dhe akumulatorët, pa dallim të formës së tyre, vëllimit, peshës, materialit prej të cilit janë përbërë ose dedikimit për shfrytëzim.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për bateritë dhe akumulatorët që shfrytëzohen në:

- pajisjen e cila është e dedikuar për shfrytëzim në mbrojtje, armë, municion dhe material luftarak, me përjashtim të prodhimeve të cilat nuk janë të dedikuara për qëllime luftarake konkrete dhe
- pajisje të dedikuara për dërgim në kozmos.

(3) Në veprimin me bateritë dhe akumulatorët dhe bateritë dhe akumulatorët e hedhur krahas dispozitave të këtij ligji, në mënyrë përkatëse do të zbatohen edhe dispozitat e rregullave që e rregullojnë menaxhimin me automjetet e përdorura dhe hedhurinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike.

(4) Të gjitha masat, standardet dhe qëllimet e përcaktuara me këtë ligj, zbatohen si kërkesa minimale që duhet të plotësohen gjatë menaxhimit me bateri dhe akumulatorë.

(5) Nëse me ligj tjetër janë përcaktuar masa dhe standarde më të rrepta të mjedisit jetësor, gjatë menaxhimit me bateri dhe akumulatorë zbatohen masat dhe standardet më të rrepta me qëllim të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe arritjes së qëllimeve të mjedisit jetësor.

Neni 5

Definicione

Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin në vijim:

1. "Bateri ose akumulator" është çdo burim i energjisë elektrike të krijuar me shndërrimin e drejtpërdrejtë të energjisë kimike, i cili përmban një ose më shumë qeli primare të baterisë (të cilat nuk mund të mbushen sërish), ose përmban një ose më shumë qeli sekondare të baterisë (të cilat mund të mbushen përsëri);
2. "Paketim i baterive" është çdo komplet i baterive ose akumulatorëve që janë të lidhur ndërmjet veti dhe/ose të mbyllur në formë të kapsollës me mbështjellës të jashtëm duke krijuar një njësi të plotë që nuk është dedikuar për ndarje ose për hapje nga ana e shfrytëzuesit të fundit;
3. "Bateri ose akumulator të bartshëm" është çdo bateri, bateri në formë të pullës, paketim i baterive ose akumulatorëve që:
 - a) janë të vulosur;
 - b) mund të mbahen në dorë dhe
 - v) nuk janë bateri industriale, as akumulatorë industriale, e as bateri ose akumulatorë të automobilave;
4. "Bateri në formë të pullës" është çdo bateri e bartshme e vogël në formë rrethi ose akumulator, diametri i së cilës është më i madh se lartësia e saj dhe e cila përdoret për dedikime të veçanta si p.sh., për aparate për dëgjim, orë dore, pajisje e vogël e bartshme dhe për energji rezervë;
5. "Bateri ose akumulator të automjetit" është çdo bateri ose akumulator që shfrytëzohet si pajisje për startim dhe ndriçim të automjetit;
6. "Bateri industriale ose akumulator industrial" është çdo bateri ose akumulator i dedikuar ekskluzivisht për shfrytëzim industrial ose profesional, ose shfrytëzohet në çfarëdo lloj të automjetit elektrik;
7. "Bateri ose akumulator i hedhur" është çdo bateri ose akumulator që janë përfshirë dhe konsiderohen si hedhurina me definicionin për hedhurina në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina;
8. "Riciklim" është çdo përpunim i sërishëm i baterive dhe akumulatorëve të hedhur dhe materialeve të tyre në procesin e prodhimit të dedikuar për qëllimin e njëjtë ose për qëllim tjetër, duke e përjashtuar përpunimin energjetik.
9. "Mënjanim" është çdo operacion që mund të zbatohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për menaxhim me hedhurina;
10. "Përpunim" është çfarëdo aktiviteti i cili kryhet mbi bateritë ose akumulatorët e hedhur pas dorëzimit të tyre në stabilimentin për klasifikim, përgatitje për riciklim ose përgatitje për mënjanim;
11. "Pajisje" është cilado pajisje elektrike ose elektronike, e cila tërësisht ose pjesërisht mbushet me bateri ose akumulatorë, ose e cila është konstruktuar në mënyrë që të mund të mbushet;
12. "Operator ekonomik" është personi juridik ose fizik i cili që gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij gjatë menaxhimit me bateri dhe akumulatorë mund të jetë prodhues, tregtar, posedues, grumbullues ose person juridik ose fizik i cili kryen riciklim ose përpunim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur.

Operatorët ekonomikë të lidhur me menaxhimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur, janë:

- a) "prodhues" është personi juridik ose fizik që për herë të parë në Republikën e Maqedonisë lëshon në treg bateri ose akumulatorë, duke përfshirë edhe të tillë që janë të instaluar në pajisje ose në automjete, si veprimtari të vet, pa marrë parasysh teknikën e shitjes e cila shfrytëzohet,

duke përfshirë edhe shitjen me komunikim nga largësia (nëpërmjet telefonit, letrës standarde, e-mailit, teleshoppingut, broshurës, katalogut, etj.), si prodhues konsiderohet edhe personi fizik ose juridik i cili importon bateri dhe akumulatorë për nevojë të vet pa ndërmjetësues;

b) "tregtar" është personi juridik ose fizik i cili siguron furnizim me bateri dhe akumulatorë për shfrytëzuesin e fundit, si veprimtari të vet;

v) "posedues" është personi juridik ose fizik i cili me kryerjen e veprimtarisë së vet vazhdimisht ose përkohësisht krijon dhe/ose posedon bateri dhe akumulatorë të hedhur (si p.sh. tregtar, servise, servise për automjete, punëtori mekanike, servise të pajisjes elektronike dhe elektrike dhe të ngjashme). Si posedues sipas këtij ligji, nuk konsiderohen qytetarët ose ekonomitë familjare;

g) "shfrytëzues i fundit" është konsumatori i cili si person juridik ose fizik, për përdorim ose shfrytëzim të fundit të prodhimit tjetër, gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet, shfrytëzon bateri dhe akumulatorë dhe në këtë mënyrë pas harxhimit të tyre krijon bateri dhe akumulatorë të hedhur në lokalet e veta dhe/ose në aparatet që ai i posedon. Si shfrytëzues i fundit do të konsiderohet poseduesi ose tregtari i cili për shkak të nevojave të veta ka importuar bateri dhe akumulatorë pa ndërmjetësues;

d) "prodhues i vogël" është personi fizik ose juridik i cili lëshon në treg në Republikën e Maqedonisë bateri dhe akumulatorë në sasi jo më të mëdha se sa ato të përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji;

gj) veprues kolektiv me bateri dhe me akumulatorë të hedhur" është personi juridik i themeluar nga prodhuesit me qëllim për plotësimin e obligimeve nga neni 18 i këtij ligji, i cili ka marrë leje për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur në pajtim me nenin 22 të këtij ligji, dhe i cili fitimin e realizuar e shfrytëzon për plotësimin e obligimeve nga neni 18 i këtij ligji dhe

e) "veprues i pavarur me bateri dhe akumulatorë të hedhur është personi juridik ose fizik i cili ka marrë leje për veprim të pavarur me bateri dhe akumulatorë të hedhur në pajtim me nenin 23 të këtij ligji;

13. "Lëshimi në treg" është furnizimi ose vënia në disponim e baterive dhe akumulatorëve, qoftë me pagesë ose pa pagesë, personit të tretë, duke përfshirë edhe importin e baterive dhe akumulatorëve;

14. "Vegël elektrike pa tela" është çdo aparat manual, i cili mbushet nga bateri ose akumulatori dhe dedikohet për mirëmbajtje, për aktivitete ndërtimore ose kopshtare;

15. "Qëllim nacional për grumbullim" është, në vitin e caktuar kalendarik, përqindja e cila fitohet me ndarjen e peshës së baterive dhe akumulatorëve të bartshëm të hedhur, të grumbulluar në pajtim me këtë ligj ose me dispozitat e ndonjë ligji tjetër që kanë të bëjnë me grumbullimin e pajisjes elektrike dhe elektronike në këtë vit kalendarik, me peshën mesatare të baterive dhe akumulatorëve të bartshëm, që prodhuesi në mënyrë të drejtpërdrejtë ua shet shfrytëzuesve të fundit ose ua dërgon personave të tretë, me qëllim që ata t'ua shesin shfrytëzuesve të fundit gjatë atij viti kalendarik dhe dy viteve kalendarike paraprake;

16. "Vendgrumbullim" është vendi në objekt, lokal ose vend të hapur ku është vendosur enë përkatëse për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur me qëllim që të njëjtit të merren për grumbullim, selektim, përpunim ose riciklim;

17. "Menaxhimi me bateritë dhe akumulatorët e hedhur" është përmbledhje e aktiviteteve, masave dhe vendimeve të dedikuara për arritjen e qëllimeve nacionale për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur, e janë të marrë në pajtim me këtë ligj dhe me rregullat që e rregullojnë menaxhimin dhe veprimin me hedhurinat;

18. "Marrëveshje vullnetare" është marrëveshja formale e cila ka klauzola zbatuese e lidhur ndërmjet organeve të pushtetit qendror dhe lokal nga njëra anë dhe organizatave të cilat përfaqësojnë interesa të caktuara të operatorëve ekonomikë, grupeve të operatorëve ekonomikë dhe operatorëve ekonomikë individualë nga ana tjetër, me qëllim që të arrihen

qëllimet e këtij ligji të përcaktuara në nenin 3 dhe qëllimet nacionale nga neni 35 të këtij ligji, i cili është i hapur për qasje të të gjithë personave juridikë dhe fizikë që dëshirojnë t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara në marrëveshje. Marrëveshja vullnetare është e kapshme për publikun në pajtim me këtë ose ligj tjetër;

19. "Organi për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor" është Drejtoria e Mjedisit Jetësor, organ në përbërje të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor;

20. "Sisteme për raste urgjente" janë sisteme që shfrytëzohen në rast kur ka nevojë për mbushje rezervë me burim të energjisë në spitale, aeroporte, trena ose aeroplanë, në sistemet për alarmim duke përfshirë edhe ndriçimin, si dhe në raste tjera ku për kryerjen e veprimtarisë është e domosdoshme mbushja e vazhdueshme me energji (p.sh. terminale për arkëtim, karroca invalide, dyer elektrike e të ngjashme) dhe

21. "Person tjetër juridik i pavarur" është personi juridik i regjistruar për kryerjen e shërbimeve profesionale, teknike dhe konsultuese nga sfera e ekonomisë dhe mjedisit jetësor.

Neni 6

Parimet

(1) Në pajtim me qëllimet për mbrojtje afatgjatë dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe mbrojtjes dhe avancimit të medimeve dhe sferave të mjedisit jetësor, menaxhimi me bateritë dhe akumulatorët bazohet në parimet në vijim:

1) parimi i përgjegjësisë së prodhuesit sipas të cilit prodhuesi është përgjegjës për ndërmarrjen e masave për menaxhim me bateritë dhe akumulatorët me qëllim që të eliminohet dhe/ose zvogëlohet deri në masën e fundit të mundshme, ndikimi negativ mbi medimet dhe sferat e mjedisit jetësor, që ndodh si rezultat i baterive dhe akumulatorëve të hedhur i krijuar nga veprimtaria e vet, duke përfshirë edhe krijimin e kushteve për realizim të shkallës së lartë të grumbullimit të tyre nga shfrytëzuesit e fundit dhe përpunimi i tyre dhe

2) parimi i vlerësimit të ciklit jetësor të prodhimit sipas të cilit prodhuesi i baterive dhe akumulatorëve është i obliguar të kryejë vlerësim të ciklit jetësor të baterisë dhe akumulatorit në mënyrë që të mundësohet rritja e realizimeve ekologjike të baterisë dhe akumulatorit, përjashtim ose zvogëlim të pranisë së substancave të rrezikshme në bateritë dhe akumulatorët në pajtim me arritjet shkencore dhe teknike dhe t'i dizajnojë në mënyrë që të kontribuojë për zvogëlimin e hedhurinave që krijohen nga bateritë dhe akumulatorët e hedhur me qëllim të parandalimit të ndikimeve negative mbi medimet dhe sferat e mjedisit jetësor.

(2) Në menaxhimin me bateri dhe akumulatorë, krahas parimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe parimet e përcaktuara në Ligjin për mjedisin jetësor dhe Ligjin për menaxhim me hedhurina.

II. KËRKESAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR

Neni 7

Kërkesat për lehtësimin e mënjanimin

(1) Prodhuesit janë të obliguar që t'i dizajnojë pajisjet në mënyrë që do të mundësojë që shfrytëzuesi i fundit lehtësisht t'i mënjanojë bateritë dhe akumulatorët e hedhur.

(2) Me pajisjet në të cilat janë instaluar bateritë dhe akumulatorët

prodhuesit janë të obliguar të paraqesin udhëzim i cili e tregon mënyrën e sigurt të mënjanimi të baterive dhe akumulatorëve dhe, nëse është e nevojshme, e informojnë shfrytëzuesin e fundit për llojin e baterive dhe akumulatorëve të instaluar.

(3) Prodhuesit nuk janë të obliguar ta paraqesin udhëzimin nga paragrafi (2) i këtij neni në rast kur për shkaqe sigurie, operative ose mjekësore ose për sigurimin e të dhënave të tërësishme, është e domosdoshme mbushja e vazhdueshme me energji dhe lidhja e vazhdueshme e pajisjes me baterinë ose akumulatorin.

Neni 8

Ndalime për praninë e materialeve të rënda

(1) Ndalohet lëshimi në tregun e Republikës së Maqedonisë i:

- a) të gjitha baterive ose akumulatorëve, pa marrë parasysh nëse janë të instaluar në pajisje, që përmbajnë 0,0005% zhivë sipas peshës dhe
- b) bateri ose akumulatorë të bartshëm, duke i përfshirë edhe ato që janë të instaluar në pajisjet, që përmbajnë më shumë se 0,002% kadmium sipas peshës.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, bateritë në formë të pullës mund të përmbajnë zhivë jo më shumë se 2% sipas peshës.

(3) Ndalimi nga paragrafi (1) të këtij neni nuk zbatohet për bateritë dhe akumulatorët e bartshëm të dedikuar për përdorim në:

- a) sisteme për raste urgjente dhe sisteme për alarmim, duke përfshirë edhe ndriçimin në raste urgjente;
- b) pajisje mjekësore ose
- v) vegla elektrike pa tela.

Neni 9

Deponimi dhe djegia

(1) Ndalohet mënjanimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve dhe industriale.

(2) Ndalohet djegia e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve dhe industriale.

(3) Mbeturinat nga cilat do bateri dhe akumulatorë që kanë kaluar nëpër operacionet e përpunimit ose riciklimit në pajtim me këtë ligj dhe operacionet për përpunim dhe riciklim të përcaktuara në Ligjin për menaxhim me hedhurina mund të mënjanoen në plehërishta ose të mënjanoen me anë të procedurës së djegies.

III. OBLIGIMET E PRODHUESVE

Neni 10

Shënimi

(1) Prodhuesi obligohet që të gjitha bateritë dhe akumulatorët, si dhe paketimet e baterive të cilat i lëshon në tregun e Republikës së Maqedonisë t'i shënojë në mënyrë përkatëse me simbol të posaçëm për grumbullim të veçantë të baterive dhe akumulatorëve të hedhur, si dhe ta shënojë kapacitetin e tyre.

(2) Prodhuesi obligohet që bateritë, akumulatorët dhe bateritë në formë të pullës, që përmbajnë më shumë se 0,0005% zhivë, më shumë se 0,002% kadmium ose më shumë se 0,004% plumb, t'i shënojë edhe me simbolin kimik për metalin përkatës; Hg, Cd ose Pb.

(3) Prodhuesi obligohet që shenjat nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni të jenë të dukshme qartësisht, të lexueshme dhe të paraqitura në mënyrë të pashlyeshme.

(4) Mënyrën e shënimit të baterive dhe akumulatorëve dhe i paketimeve të baterive, si dhe formën dhe përmbajtjen e simboleve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e ekonomisë.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e ekonomisë, në bazë të kërkesës së veçantë nga prodhuesi, mund të miratojë përjashtime nga shënimi i baterive dhe akumulatorëve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nëse nuk është e mundur për shkaqe teknike të shtypet në to, ose në rast kur bateritë dhe akumulatorët lëshohen në treg për dedikim të vetëm mënjanimi i të cilave u nënshtrohet rregullave të veçanta për mënjanim lidhur me dedikimin.

(6) Kur kjo është e nevojshme për barazimin e kushteve për lëshim në treg të baterive dhe akumulatorëve, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor pas konsultimit me prodhuesit, mund të përcaktojë edhe mënyra të veçanta për shënimin e kapacitetit të baterive dhe akumulatorëve dhe metodologjitë për përcaktimin e kapacitetit.

Neni 11

Lëshimi në treg

(1) Bateria ose akumulatori mund të lëshohet në treg me kusht që t'i plotësojë kërkesat themelore të përcaktuara në këtë ligj, që kanë të bëjnë me përbërjen e baterive dhe akumulatorëve, mënyrën e shënimit të tyre dhe sistemet e themeluara për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur, duke përfshirë edhe volitshmërinë për përpunimin, përkatësisht riciklimin e tyre.

(2) Nuk mund të ndalohet lëshimi në tregun e Republikës së Maqedonisë i baterive dhe i akumulatorëve, nëse i plotësojnë kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nëpërmjet organit administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor (në tekstin e mëtejme: organi profesional) dhe Inspektorati Shtetëror i Tregut, është i obliguar që t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që të sigurojë që bateritë dhe akumulatorët që nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj të mos lëshohen në tregun e Republikës së Maqedonisë ose të tërhiqen nga tregu.

Neni 12

Regjistrimi i prodhuesve

(1) Prodhuesit që për herë të parë lëshojnë në treg ose importojnë si shfrytëzues të fundit bateri dhe akumulatorë në Republikën e Maqedonisë, janë të obliguar të regjistrohen për këtë në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor (në tekstin e mëtejme: organi profesional).

(2) Regjistrimi kryhet me parashtrimin e kërkesës për regjistrim, nga ana e prodhuesit te organi profesional në formë elektronike ose të shkruar, e

cila i përmban të dhënat në vijim:

- 1) emrin e prodhuesit dhe markat tregtare (nëse i posedon) që prodhuesi i shfrytëzon gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet;
- 2) adresën e prodhuesit: numrin postar dhe selinë, rrugën dhe numrin, ueb adresën, numrin e telefonit, si dhe personin për kontakt, numrin e faksit dhe postën elektronike, nëse ekziston;
- 3) emrin dhe shenjën e llojit të baterive dhe akumulatorëve që i lëshon në treg: bateri dhe akumulatorë të bartshëm, bateri dhe akumulatorë industrialë ose bateri dhe akumulatorë për automjete me dëshmi për përmbajtjen e substancave nga neni 10 paragrafi (2) i këtij ligji;
- 4) informatat për mënyrën me të cilën prodhuesi i plotëson ose do t'i plotësojë obligimet që dalin nga ky ligj (veprim individual ose kolektiv) me përshkrim të sistemit;
- 5) numrin unik të subjektit afarist dhe numrin tatimor;
- 6) regjistrimin e prodhuesit;
- 7) deklaratën në të cilën thekson se informatat e paraqitura për regjistrim janë të vërteta dhe
- 8) llojin e prodhimeve në të cilat janë instaluar bateritë dhe akumulatorët.

(3) Në bazë të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, organi profesional është i obliguar që në afat prej shtatë ditësh nga parashtrimi i kërkesës, prodhuesit t'i parashtrorë vërtetim për regjistrim në regjistrin nga paragrafi (4) i këtij neni dhe numrin e regjistrimit për lëshim në treg në Republikën e Maqedonisë të baterive dhe akumulatorëve (në tekstin e mëtejshëm: numri i regjistrimit).

(4) Organi profesional mban regjistër të prodhuesve të cilët lëshojnë në treg në Republikën e Maqedonisë bateri dhe akumulatorë.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të kërkesës për regjistrim nga paragrafi (2) i këtij neni, mënyrën e themelimit të numrit të regjistrimit, si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrimit të prodhuesve të cilët lëshojnë në treg në Republikën e Maqedonisë bateri dhe akumulatorë nga paragrafi (4) të këtij neni.

(6) Organi profesional është i obliguar që një kopje nga vërtetimi për regjistrim të prodhuesit nga paragrafi (3) i këtij neni, të dorëzojë edhe deri te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e doganës (në tekstin e mëtejshëm: organi i doganës).

(7) Në rast të ndryshimit të të dhënave të parashtruara gjatë regjistrimit nga paragrafi (2) i këtij neni, prodhuesi është i obliguar që në afat prej 30 ditësh nga dita e shkaktimit të ndryshimit, të parashtrorë kërkesë për ndryshimin e regjistrimit në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni. Në kërkesë parashtrorë informata vetëm për ato të dhëna të cilat janë ndryshuar.

(8) Në rast kur prodhuesi do të pushojë ta kryejë veprimtarinë lëshim në treg në Republikën e Maqedonisë të baterive dhe akumulatorëve është i obliguar që në afat prej 30 ditësh nga dita e ndërprerjes, të parashtrorë kërkesë për shlyerjen nga regjistri nga paragrafi (4) i këtij neni te organi profesional. Shlyerja nga regjistri i prodhuesit kryhet edhe me propozim të inspektorit, nëse konstatohet se nuk i plotëson kërkesat e këtij ligji.

(9) Organi profesional është i obliguar që në afat prej 8 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (8) i këtij neni t'i parashtrorë prodhuesit vërtetim për shlyerjen nga regjistri nga paragrafi (4) i këtij neni.

(10) Organi profesional është i obliguar që një kopje nga shlyerja nga regjistri i prodhimeve të parashtrorë edhe te organi i doganës.

(11) Organi profesional është i obliguar që në ueb faqen e tij ta publikojë dhe rregullisht ta azhurnojë regjistrin nga paragrafi (4) i këtij neni.

Neni 13

Ndalimi për import të baterive dhe akumulatorëve

Organi i doganës nuk do të lejojë import të baterive dhe akumulatorëve pa e parashtruar prodhuesi vërtetimin për regjistrim dhe numrin e regjistrimit nga neni 12 paragrafi (3) i këtij ligji.

IV. VEPRIMI ME BATERITË DHE AKUMULATORËT E HEDHUR

Neni 14

Ndalimet për lënie

Ndalohet që bateritë dhe akumulatorët e hedhur të lihen ose të dorëzohen në vende të shënuara për grumbullim dhe seleksionim të hedhurinave komunale nga amvisëritë ose lloj tjetër të hedhurinave.

Neni 15

Obligimet e shfrytëzuesve të fundit

(1) Secili është i obliguar që bateritë dhe akumulatorët e hedhur t'i ruajë, grumbullojë dhe t'i le të ndarë nga hedhurinat e komunalieve dhe llojet tjera të hedhurinave.

(2) Shfrytëzuesit e fundit janë të obliguar që bateritë dhe akumulatorët e hedhur të bartshëm që i krijojnë t'i lënë në vende të caktuara për atë qëllim, ose t'ua dorëzojnë personave juridikë ose fizikë që posedojnë licenca për veprim me hedhurina, në pajtim me rregullat për menaxhim me hedhurina.

(3) Shfrytëzuesi i fundit është i obliguar që bateritë dhe akumulatorët e hedhur të automjeteve që i krijojnë, t'ia dorëzojë shitësit nga i cili i ka blerë, ose poseduesit i cili ka kryer shërbim servisor për shfrytëzuesin e fundit ose t'ua dorëzojë personave fizikë ose juridikë që posedojnë leje për veprim me hedhurina, në pajtim me rregullat për menaxhim me hedhurina.

(4) Shfrytëzuesi i fundit është i obliguar që bateritë dhe akumulatorët e hedhur industrialë, t'ia dorëzojë prodhuesit nga i cili i ka blerë ose personave juridikë ose fizikë që posedojnë leje për veprim me hedhurina, në pajtim me rregullat për menaxhim me hedhurina, me të cilin prodhuesi ka lidhur marrëveshje për grumbullim dhe veprim.

(5) Bateritë dhe akumulatorët e hedhur grumbullohen ndaras sipas llojit, në mënyrën e cila do ta lehtësojë trajtimin dhe/ose riciklimin e tyre të mëtejshëm.

(6) Bateritë dhe akumulatorët e hedhur të bartshëm lihen dhe grumbullohen të ndarë nga llojet tjera të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në enë të shënuara të veçanta për grumbullim.

Neni 16

Obligime për pranim dhe kthim

(1) Asnjë posedues dhe tregtar nuk guxon ta refuzojë dorëzimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bartshëm nga ana e shfrytëzuesit të fundit, e as të kërkojë kompensim për këtë blerjen e baterive dhe/ose akumulatorë të rinj ose të arkëtojë kompensim për kthimin.

(2) Prodhuesi i baterive dhe akumulatorëve të automjeteve dhe

industrialë, si dhe persona të tretë që punojnë në emër të tij, duke përfshirë edhe poseduesin i cili punon me bateri dhe akumulatorë të automjeteve dhe industrialë të prodhuesit, është i obliguar që falas t'i marrë prapa bateritë dhe akumulatorët e automjeteve dhe industrialë nga shfrytëzuesit e fundit, pa marrë parasysh përbërjen e tyre kimike ose origjinën.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni mund të përcaktohet mënyrë tjetër e kthimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve dhe industrialë, vetëm nëse mënyra e tillë është përcaktuar në marrëveshjen për shitblerje, e lidhur ndërmjet prodhuesit, poseduesit dhe/ose tregtarit me shfrytëzuesin e fundit, dhe nëse nuk është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 17

Obligimet e poseduesit dhe tregtarit

(1) Poseduesi është i obliguar të vendosë enë përkatëse, në vende për grumbullim në lokalit të vet afarist ose në afërsi, për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bartshëm që ai i ka shfrytëzuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet, ose i kanë shfrytëzuar klientët e tij që për shkak të veprimtarisë të cilën e kryen poseduesi i mënjanon bateritë dhe akumulatorët e hedhur, përkatësisht të sigurojë hapësirë për lënie e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve dhe industrialë.

(2) Tregtari është i obliguar që të vendosë enë përkatëse në vende për grumbullim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bartshëm në hapësirën e tij të shitjes, që sipas madhësisë dhe vëllimit u përgjigjen sasive mesatare të baterive dhe akumulatorëve që i shet në nivel vjetor.

(3) Tregtari është i obliguar që t'i marrë bateritë dhe akumulatorët e hedhur që i ka në programin e vet të shitjes pa kompensim ose obligim për blerje nga shfrytëzuesi i fundit, pa marrë parasysh se kush është prodhuesi i tyre, duke i përfshirë edhe bateritë dhe akumulatorët e hedhur që janë pjesë përbërëse e pajisjeve që shiten apo servisohen.

(4) Poseduesi dhe tregtari janë të obliguar që në vend të dukshëm të vendosin njoftim në të cilin do të theksohen informata për shfrytëzuesin e fundit për mënyrën e grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në vendet për grumbullim në kuadër të lokalit të vet afarist.

(5) Poseduesi dhe tregtari janë të obliguar që bateritë dhe akumulatorët e hedhur të grumbulluar t'ia dorëzojnë prodhuesit ose personit të autorizuar nga ai për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur sipas këtij ligji.

(6) Për vendet për grumbullim, si dhe për bateritë dhe akumulatorët e hedhur të bartshëm të grumbulluar në kuadër të lokalit të vet, poseduesi dhe tregtari nuk duhet të posedojnë leje për grumbullim të hedhurinave të rrezikshme në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina.

(7) Me bateritë dhe akumulatorët e automjeteve dhe industrialë të grumbulluar poseduesi duhet të veprojë në pajtim me rregullat për veprim me hedhurina të rrezikshme të përcaktuara me Ligjin për menaxhim me hedhurina.

(8) Tregtari i cili bën shitjen e baterive dhe akumulatorëve duke përfshirë edhe bateritë dhe akumulatorët që janë të instaluar në pajisjen elektrike dhe elektronike është i obliguar që

- bateritë dhe akumulatorët që i shet të sigurojë: që bateritë dhe akumulatorët të kenë shenjë në pajtim me nenin 10 të këtij ligji,
- se ato janë të importuara nga ana e prodhuesit i cili ka vërtetim për numër të regjistrimit në pajtim me nenin 12 të këtij ligji;
- deklaratë me shkrim nga personi juridik nga i cili e blen mallin se ka

marrëveshje të lidhur me vepruesin kolektiv nga neni 22 i këtij ligji ose se ky person juridik është veprues i pavarur nga neni 23 i këtij ligji ose
 - deklaratë me shkrim se bateritë dhe akumulatorët burojnë nga personi juridik i cili është prodhues i vogël në pajtim me nenin 20 të këtij ligji.

Neni 18

Obligimet e prodhuesit

(1) Prodhuesi i baterive dhe akumulatorëve është i obliguar që në llogari të vet, në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet vepruesit kolektiv me bateri dhe akumulatorë të hedhur nga neni 22 i këtij ligji të sigurojë grumbullim, përpunim dhe riciklim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur nga shfrytëzuesi i fundit pa marrë parasysh përbërjen kimike, origjinën ose datën kur për herë të parë janë të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë.

(2) Obligimin nga paragrafi (1) i këtij neni, prodhuesi është i obliguar ta realizojë nëpërmjet grumbullimit, përpunimit dhe/ose riciklimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të cilët për herë të parë i lëshon në treg në Republikën e Maqedonisë me:

- marrjen e rregullt të baterive dhe akumulatorëve të hedhur nga vendet për grumbullim,
- përmbushjen e qëllimeve nacionale për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bartshëm nga neni 35 i këtij ligji, përkatësisht plotësimin e sasive për grumbullim të përcaktuara në pajtim me nenin 40 paragrafi (1) pika 4 të këtij ligji, për bateritë dhe akumulatorët e hedhur të automjeteve dhe industrialë dhe
- sigurimin e trajtimit të tyre dhe riciklimit me qëllim të plotësimin të shkallës së efikasitetit të riciklimit nga neni 26 paragrafi (3) i këtij ligji.

(3) Prodhuesi, i cili njëkohësisht është shfrytëzues i fundit, është i obliguar që me shpenzimet e veta të sigurojë plotësimin e obligimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, nëpërmjet grumbullimit, trajtimit dhe riciklimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të cilat i ka prodhuar ose importuar në Republikën e Maqedonisë.

(4) Obligimet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohen për bateritë dhe akumulatorët që eksportohen.

(5) Prodhuesi është i obliguar që në llogari të vet, ta informojë publikun për:

- ndikimet e mundshme mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e njeriut nga substancat që shfrytëzohen në bateri dhe akumulatorë,
- nevojën që të mos bëhet dorëzimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur në hedhurinat e komunalieve dhe të grumbullohen ndaras me qëllim që të mundësohet përpunimi dhe riciklimi i tyre,
- programet për grumbullim dhe riciklim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të cilat ekzistojnë,
- kontributin e qytetarëve në riciklimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur dhe
- domethënien e simbolit nga neni 10 i këtij ligji me të cilin janë shënuar bateritë dhe akumulatorët dhe simbolet për elementet kimike: Hg, Cd, dhe Pb.

(6) Prodhuesi është i obliguar që në llogari të vet, ta informojë publikun edhe për realizimin e fushatave për informim publik për grumbullim, trajtim dhe për riciklim të të gjitha baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bartshëm.

(7) Shpenzimet për grumbullim, trajtim dhe riciklim të cilat i bart prodhuesi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxon t'i paraqesë ndaras gjatë shitjes së baterive dhe akumulatorëve.

(8) Shpenzimet për grumbullim, trajtim dhe riciklim të cilat i bart prodhuesi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxojnë të dyfishohen lidhur

me shpenzimet e njëjta që bëhen gjatë veprimit me automjetet e përdorura dhe pajisjet elektronike dhe elektrike të hedhura.

(9) Obligimi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk ka të bëjë me prodhuesit e vegjël nga neni 20 i këtij ligji.

Neni 19

Obligimi për grumbullim

(1) Për realizimin e obligimeve nga neni 18 i këtij ligji, prodhuesi është i obliguar që me shpenzimet e veta të sigurojë grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur nga enët e poseduesit dhe tregtarit në afat prej 48 orësh nga momenti kur poseduesi ose tregtari ka kërkuar t'i dorëzojë bateritë dhe akumulatorët e hedhur të grumbulluar.

(2) Për përmbushjen e obligimit nga paragrafi (1) i këtij neni, prodhuesi është i obliguar që me shpenzimet e veta për poseduesin ose tregtarin të sigurojë enë përkatëse për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur, që do të vendosen në pajtim me nenin 18 të këtij ligji, në vendet për grumbullim në lokalet e poseduesit ose tregtarit në të cilat prodhuesi u shet bateri dhe akumulatorë.

(3) Obligimin nga paragrafi (2) i këtij neni, prodhuesi mund ta realizojë në mënyrë të pavarur, nëse posedon leje nga neni 22 i këtij ligji, me ose pa ndërmjetësim të personave të tretë, që posedojnë leje për grumbullim të hedhurinave të rrezikshme të marrë në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina dhe/ose leje tjetër përkatëse në pajtim me ligjin.

(4) Obligimin nga paragrafi (2) i këtij neni, prodhuesi mund ta realizojë nëpërmjet vepruesit kolektiv me bateri dhe akumulatorë të hedhur nga neni 22 i këtij ligji, me ndërmjetësim të personave të tretë që posedojnë leje për grumbullim të hedhurinave të rrezikshme të marrë në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina dhe/ose leje tjetër përkatëse në pajtim me ligjin.

Neni 20

Lirimi – prodhuesi i vogël

(1) Obligimi nga neni 18 dhe 19 i këtij ligji ka të bëjë vetëm me atë prodhues, i cili në nivel vjetor ka lëshuar në treg ose ka importuar në Republikën e Maqedonisë më shumë sesa sasi të baterive dhe akumulatorëve në vijim:

- 50 kg bateri të barrshme,
- 10 kg bateri në formë pulle,
- 100 kg akumulatorë të automjeteve dhe /ose
- një copë bateri dhe akumulatorë industrialë.

(2) Sasi të nga paragrafi (1) i këtij neni llogariten si një vlerë pa marrë parasysh llojin e baterisë ose akumulatorit, origjinën ose vlerën.

(3) Prodhuesi nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar që të regjistrohet në pajtim me nenin 12 të këtij ligji, si dhe të mbajë evidencë në pajtim me nenin 30 të këtij ligji.

(4) Në procedurën për regjistrim nga neni 12 i këtij ligji, prodhuesi i vogël është i obliguar të kërkojë marrjen e aktvendimit me të cilin do të përcaktohet si prodhues i vogël, me këtë rast duke e theksuar sasinë e baterive dhe akumulatorëve që për herë të parë ka për qëllim ta lëshojë në tregun e Republikës së Maqedonisë.

(5) Aktvendimin nga paragrafi (4) i këtij neni e lëshon organi profesional bashkë me vërtetimin për regjistrim nga neni 12 paragrafi (3) i këtij ligji.

(6) Organi profesional është i obliguar që në regjistrin në neni 12 paragrafi

(4) i këtij ligji veç e veç t'i paraqesë prodhuesit për të cilët ka lëshuar leje për prodhues të vogël dhe t'i publikojë dhe azhurnojë në pajtim me nenin 12 paragrafi (4) i këtij neni.

Neni 21

Veprimi kolektiv me bateritë dhe akumulatorët e hedhur

(1) Përbushja e obligimeve nga neni 18 i këtij ligji, si dhe përbushja e qëllimeve nacionale nga neni 35 i këtij ligji, përkatësisht grumbullimi i sasive të përcaktuara në pajtim me nenin 40 paragrafi (1) pika 4 të këtij ligji, prodhuesi, mund t'i realizojë në mënyrë të pavarur ose me lidhjen e marrëveshjes së veçantë për marrjen e obligime për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur me personin juridik i cili në pajtim me këtë ligj është i autorizuar për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur në emër të tyre dhe në llogari të tyre (në tekstin e mëtejshëm: veprues kolektiv).

(2) Vepruesi kolektiv është i obliguar të sigurojë zbatimin e obligimeve në emër dhe në llogari të prodhuesit nga nenet 18 dhe 19 të këtij ligji.

(3) Për realizimin e obligimeve nga paragrafi (2) i këtij neni, vepruesi kolektiv është i obliguar të sigurojë leje në pajtim me nenin 22 të këtij ligji.

(4) Kryerjen e punëve nga paragrafi (2) i këtij neni, vepruesi kolektiv nuk mund t'i kryejë në mënyrë të pavarur dhe është i obliguar t'ua ngarkojë personave të tretë të cilët janë të regjistruar për kryerjen e atyre punëve dhe posedojnë leje përkatëse në pajtim me këtë ligj dhe/ose me Ligjin për menaxhim me hedhurina dhe Ligjin për mjedisin jetësor.

(5) Prodhuesi nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar që vepruesit kolektiv me të cilin ka lidhur marrëveshje për realizimin e obligimeve nga neni 18 dhe 19 i këtij ligji, t'i paguajë çmim përkatës për shërbimin lidhur me realizimin e obligimeve për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur në përpjesëtim me sasinë e baterive dhe akumulatorëve që prodhuesi i lëshon për herë të parë në tregun e Republikës së Maqedonisë.

(6) Kryerjen e punëve nga paragrafi (2) i këtij neni vepruesi kolektiv mund t'i kryejë si një veprimtari ose së bashku me veprimtarinë për veprim me pajisjen elektrike dhe elektronike të hedhur ose me veprimtarinë për veprim me automjete të përdorura, nëse për këtë posedon leje në pajtim me ligjin

(7) Personat fizikë dhe juridikë që në emër dhe në llogari të vepruesit kolektiv ose vepruesit të pavarur nga neni 23 i këtij ligji, kryejnë veprimtari për grumbullim, transport dhe/ose magazinim të përkohshëm të baterive ose akumulatorëve të hedhur, duhet të posedojnë leje për grumbullim dhe transport të hedhurinave të marrë në pajtim me rregullat për menaxhim me hedhurina.

(8) Me përjashtim nga paragrafi (7) i këtij neni për grumbullim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në vendet për grumbullim të poseduesit dhe tregtarët ku kryhet shitja e baterive dhe akumulatorëve, nëse janë pjesë e sistemit për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur të vepruesit kolektiv ose vepruesit të pavarur nga neni 23 i këtij ligji nuk kanë për obligim të posedojnë leje për grumbullim të përkohshëm dhe magazinim të hedhurinave në pajtim me rregullat për menaxhim me hedhurina.

Neni 22

Vepruesi kolektiv

(1) Vepruesi kolektiv mund të veprojë me bateri dhe akumulatorë të hedhur për llogari të prodhuesve, nëse ka siguruar marrëveshje për

marrjen e obligimeve për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur me prodhuesit të cilët së bashku lëshojnë në tregun e Republikës së Maqedonisë së paku 15% por jo më shumë se 51% të baterive dhe akumulatorëve bartës dhe/ose së paku 5% të baterive dhe akumulatorëve industrial dhe/ose të automobilave gjatë një viti kalendarik dhe të posedojë leje nga paragrafi (2) i këtij neni.

(2) Vepruesi kolektiv është i obliguar të posedojë leje për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në bazë të kërkesës me shkrim e cila përmban veçanërisht:

- 1) emrin dhe selinë e personit juridik kolektiv;
- 2) listën e ndërmjetësuesve dhe tregtarëve me të cilët ka lidhur marrëveshje për grumbullim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur;
- 3) periudhën kohore për të cilën kërkohet leja;
- 4) statutin e subjektit juridik kolektiv;
- 5) listën me emrin, adresën, veprimtarinë, numrin e regjistrimit nga neni 12 i këtij ligji, numrin e subjektit afarist dhe numrin tatimor të prodhuesve në emër të të cilëve dhe në llogari të të cilëve do të veprojë me bateritë dhe akumulatorët e hedhur;
- 6) dëshminë se në momentin e parashtrimit të kërkesës, ka lidhur marrëveshje për marrjen e obligimeve për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur nga persona juridikë dhe fizikë, që janë të regjistruar në pajtim me nenin 12 të këtij ligji dhe që së bashku lëshojnë në treg ose importojnë në Republikën e Maqedonisë së paku 5% të sasive të baterive dhe akumulatorëve në pajtim me llojet për të cilat kërkojnë leje në vitin paraprak dhe mënyrën në të cilën planifikon në afat prej një viti, nga dita e marrjes së lejes, ta plotësojë kushtin nga paragrafi (1) i këtij neni;
- 7) dëshminë se ka lidhur së paku një marrëveshje me person juridik për përpunim dhe riciklim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur, i cili posedon leje për këtë në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina dhe leje të integruar ekologjike në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor ose leje ekuivalente me to, kur personi juridik për përpunim dhe riciklim ndodhet në vend të huaj dhe
- 8) programin për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur nga neni 24 i këtij ligji.

(3) Krahas dokumenteve nga paragrafi (2) i këtij neni, e varësisht prej llojit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur, organi profesional sipas nevojës mund të kërkojë që kërkuesi të parashtrorë edhe të dhëna tjera plotësuese në pajtim me këtë dhe ligj tjetër.

(4) Nëse vjen në ndryshimin e të dhënave të parashtruara me kërkesën nga paragrafi (2) i këtij neni, vepruesi kolektiv është i obliguar ta njoftojë organin profesional më së voni në afat prej dy muajsh nga momenti i shkaktimit të ndryshimit.

(5) Leja nga paragrafi (2) i këtij neni lëshohet për periudhë prej më së shumti pesë vjet.

(6) Lejen nga paragrafi (2) i këtij neni e lëshon organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në bazë të propozimit të organit profesional.

(7) Leja nga paragrafi (2) i këtij neni mund të lëshohet për veprim me më shumë lloje të baterive dhe akumulatorëve ose vetëm për lloje të veçanta në pajtim me kërkesën e parashtruar.

(8) Vepruesi kolektiv prodhuesve me të cilët ka lidhur marrëveshje për marrjen e obligimit për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur është i obliguar t'u japë vërtetim për lirim nga pagesa e kompensimit të përcaktuar në nenin 39 të këtij ligji.

(9) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e refuzon kërkesën për lëshimin e

lejes nga paragrafi (2) i këtij neni, parashtruesi ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

(10) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

Neni 22-a

(1) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nuk lëshon leje për veprim me bateri dhe akumulatorë dhe bateri dhe akumulatorë të hedhur, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzim të kërkesës për lëshim të lejes nga neni 22 paragrafi (2) i këtij ligji në afat prej 60 ditësh, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditësh pune nga kalimi i këtij afati të paraqesë kërkesë te sekretaria e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, për marrje aktvendimi për lëshim të lejes nga neni 22 paragrafi (2) i këtij ligji. Nëse ministri nuk ka sekretari kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Formën dhe përmbajtjen e formularit nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Më kërkesë nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrues i kërkesës parashtron kopje nga neni 22 paragrafi (2) i këtij ligji për lëshim të lejes.

(4) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimt të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, për marrje të aktvendimit me të cilin kërkesa për lëshim të lejes nga neni 22 paragrafi (2) i këtij ligji, pranohet ose refuzohet.

(5) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(6) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në përputhshmëri me ligjin, dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informojë parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(7) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer sipas ligjit miraton aktvendim, me të cilin e obligon ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor që në afat prej dhjetë ditëve të vendosë për kërkesën e paraqitur, përkatësisht ta pranojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzon kopje të aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(8) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afatin nga paragrafi (7) i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ, dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e

mjedisit jetësor, do të vendosë për kërkesën e paraqitur për çfarë në afatin e njëjtë do ta informojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(9) Nëse ministri nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në këtë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(10) Nëse inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të paraqesë kundërshtim te sekretaria e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa paraqitet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimi ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (10) i këtij neni dhe nëse vërteton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit të parashtruesit të kërkesës sipas paragrafëve (6) dhe (7) të këtij neni dhe/ose nuk paraqet kallëzim në përputhshmëri me paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin, dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në përputhshmëri me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(12) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Në rastin nga paragrafi (12) i këtij neni drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(14) Në rastin nga paragrafi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në përputhshmëri me paragrafin (11) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(16) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(17) Procedura para Gjykatës Administrative është urgjente.

Neni 23

Veprimi i pavarur me bateritë dhe akumulatorët e hedhur

(1) Prodhuesit obligimet nga neni 18 i këtij ligji mund t'i realizojnë në mënyrë të pavarur, nëse për këtë kanë siguruar leje për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur dhe posedojnë vërtetim se janë të regjistruar

te organi profesional si prodhues të cilët në mënyrë të pavarur sigurojnë veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur që i lëshon për herë të parë në tregun e Republikës së Maqedonisë.

(2) Leja nga paragrafi (1) i këtij neni merret në pajtim me dispozitat e nenit 22 dhe nenit 24 të këtij ligji

(3) Në bazë të lejes së marrë, organi profesional jep vërtetim se prodhuesi është i regjistruar si prodhues i cili në mënyrë të pavarur siguron veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur (në tekstin e mëtejme: veprues i pavarur).

(4) Vepruesi i pavarur është i obliguar që t'i realizojë të gjitha obligimet të cilat në pajtim me këtë ligj janë përcaktuar si obligim për vepruesin kolektiv dhe për prodhuesin.

(5) Vepruesi i pavarur është i obliguar t'i parashtojë raportet nga neni 30 i këtij ligji.

(6) Formën dhe përmbajtjen e vërtetimit nga paragrafi (3) i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheqë me organin e administratës shtetërore kompetent për punët në sferën e mjedisit jetësor.

(7) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e refuzon kërkesën për lëshimin e lejes nga paragrafi (2) i këtij neni, parashtruesi ka të drejtë të parashtojë ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

Neni 23-a

(1) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nuk lëshon leje për veprim me hedhurina paketimi, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzim të kërkesës për lëshim të lejes nga neni 23 paragrafi (1) i këtij ligji në afat prej 60 ditësh, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditësh pune nga kalimi i këtij afati të paraqesë kërkesë te sekretaria e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor për marrje aktvendimi me të cilin jepet pëlqim për lëshim të lejes nga neni 23 paragrafi (1) i këtij ligji. Nëse ministri nuk ka sekretari kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Formën dhe përmbajtjen e formularit nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Më kërkesë nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës parashtron kopje të kërkesës nga neni 23 paragrafi (1) i këtij ligji për lëshim të lejes.

(4) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimt të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, për marrje të aktvendimit me të cilin kërkesa për lëshim të lejes nga neni 23 paragrafi (1) i këtij ligji, pranohet ose refuzohet.

(5) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(6) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni,

të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në përputhshmëri me ligjin, dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informojë parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(7) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer sipas ligjit miraton aktvendim, me të cilin e obligon ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor që në afat prej dhjetë ditëve të vendosë për kërkesën e paraqitur, përkatësisht ta pranojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzon kopje të aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(8) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afatin nga paragrafi (7) i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ, dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, do të vendosë për kërkesën e paraqitur për çfarë në afatin e njëjtë do ta informojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(9) Nëse ministri nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në këtë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(10) Nëse inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të paraqesë kundërshtim te sekretaria e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa paraqitet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (10) i këtij neni dhe nëse vërteton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit të parashtruesit të kërkesës sipas paragrafëve (6) dhe (7) të këtij neni dhe/ose nuk paraqet kallëzim në përputhshmëri me paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin, dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në përputhshmëri me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(12) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Në rastin nga paragrafi (12) i këtij neni drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(14) Në rastin nga paragrafi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon

parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në përputhshmëri me paragrafin (11) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(16) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(17) Procedura para Gjykatës Administrative është urgjente.

Neni 24

Programi për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur

(1) Programi për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur (në tekstin e mëtejme: programi) përban:

a) plan për grumbullim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur që i përban të dhënat në vijim:

- llojin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur për të cilët vepruesi kolektiv siguron grumbullim dhe veprim (në tekstin e mëtejme: sistem për veprim),

- mënyrën e realizimit të qëllimeve nacionale nga neni 35 i këtij neni dhe plotësimin e sasive nga neni 40 paragrafi (1) pika 4 e këtij ligji,

- mënyrën dhe vëllimin e grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur nga shfrytëzuesit e fundit,

- mënyrën dhe vëllimin e grumbullimit të rregullt të baterive dhe akumulatorëve të hedhur nga poseduesit dhe tregtarët,

- mënyrën dhe vëllimin e sigurimit të poseduesve dhe tregtarëve me enë përkatëse për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur që do të vendosen në vendet për grumbullim në pajtim me nenin 19 të këtij ligji,

- numrin dhe lokacionet e vendeve për grumbullim dhe qendrave që janë të përfshira në sistem dhe emrin e personave juridikë dhe fizikë që menaxhojnë me to, si dhe pasqyrë se vendet për grumbullim janë vendosur dhe sistemuar në pajtim me dendësinë e banorëve në pajtim me nenin 25 paragrafët (11) dhe (12) të këtij ligji, duke i marrë parasysht tregjet e gjelbra dhe tregjet tjera të organizuara të veçanta,

- mënyrën dhe vëllimin e marrjes së baterive dhe akumulatorëve të hedhur nga komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe nga qyteti i Shkupit në pajtim me nenin 29 të këtij ligji,

- sasinë e përgjithshme vjetore të baterive dhe akumulatorëve që për herë të parë në tregun e Republikës së Maqedonisë do t'i lëshojnë prodhuesit në emrin e të cilëve dhe në llogarinë e të cilëve vepruesi kolektiv i merr obligimet për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur,

- sasinë e baterive dhe akumulatorëve të grumbulluar që janë të dedikuar për përpunim dhe riciklim dhe,

- dëshmi se funksionimi i sistemit është financiarisht i qëndrueshëm, plan financiar për zhvillim dhe dëshmi për investimet fillestare në sistem.

b) plan për trajtim, përpunim dhe riciklim që i përban të dhënat në vijim:

- llojin dhe kapacitetin e mjeteve dhe pajisjes, të cilat i posedojnë personat juridikë për magazinim të përkohshëm, trajtim, përpunim dhe riciklim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur me të cilët vepruesi kolektiv ka lidhur marrëveshje,

- dëshmi se personat juridikë për përpunimin dhe riciklimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur shfrytëzojnë teknika më të mira të kapshme për përpunim dhe riciklim të cilat rregullisht përsosen dhe zhvillohen, si dhe sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit jetësor,

- masat me të cilat sigurohet se të gjitha bateritë dhe akumulatorët që burojnë nga pajisja elektrike dhe elektronike përpunohen dhe riciklohen në kushte në të cilat sigurohet mbrojtje e shëndetit të njerëzve dhe i mjedisit

jetësor dhe

- mënyrën e mënjanimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur që i janë nënshtruar përpunimit dhe riciklimit.

v) plan për realizimin e fushatës për ngritjen e vetëdijes publike për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur, që i përmban të dhënat në vijim:

- realizimin e së paku një fushate vjetore për ngritjen e vetëdijes publike për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur;

- masat për sigurimin e informatave për qytetarët dhe

- mënyrën dhe masat e parapara për njoftimin e publikut dhe shfrytëzuesit e fundit në pajtim me nenin 18 paragrafi (5) dhe (6) të këtij ligji.

(2) Programi nga paragrafi (1) i këtij neni hartohet për periudhë prej pesë vjetësh.

Neni 25

Sisteme për veprim

(1) Gjatë themelimit të sistemit për veprim dhe përgatitje të programit nga neni 24 i këtij ligji, vepruesi i pavarur dhe vepruesi kolektiv janë të obliguar t'i sigurojnë kushtet në vijim:

a) t'u mundësojë shfrytëzuesve të fundit t'i hedhin bateritë dhe akumulatorët e hedhur të bartshëm në vende për grumbullim të kapshme në afërsi të tyre, duke pasur parasysh dendësinë e banorëve.

b) t'i obligojë poseduesit dhe tregtarët të cilët kryejnë furnizim me bateri dhe akumulatorë të bartshëm falas t'i marrin prapa bateritë dhe akumulatorët e hedhur të bartshëm, me lidhjen e marrëveshjeve dhe

v) të mos imponojë kurrfarë shpenzimi për shfrytëzuesit e fundit kur ato hedhin bateri dhe akumulatorë dhe, as të krijojnë kurrfarë obligimi për blerjen e baterive dhe akumulatorëve të ri.

(2) Sigurimin e kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni, vepruesi i pavarur dhe vepruesi kolektiv mund t'i kryejnë bashkë me sistemet e themeluara për veprim me pajisjen e hedhur elektrike dhe elektronike ose automjetet e përdorura.

(3) Kur vepruesi i pavarur dhe vepruesi kolektiv në sistemin e vet kujdesen për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur industrialë janë të obliguar që në programin nga neni 24 i këtij ligji të sigurojnë masa poseduesi ose tregtari të mos refuzojnë t'i marrin mbrapa falas bateritë dhe akumulatorët e hedhur industrialë nga shfrytëzuesit e fundit, pa marrë parasysh përbërjen e tyre kimike dhe origjinën, përveç nëse ekziston marrëveshje e veçantë me shfrytëzuesit, grumbullimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bëhet në mënyrë tjetër për mbulimin e shpenzimeve.

(4) Vepruesi i pavarur dhe vepruesi kolektiv i cili në sistemin e vet kujdeset për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur industrialë është i obliguar në program t'i theksojë veçanërisht aktivitetet që do t'i marrë për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve nga poseduesit dhe shfrytëzuesit e fundit ose nga vendet për grumbullim të kapshme në afërsi të tyre, vendet për shitje, ose vendet tjera të kapshme ku krijohet ky lloj i hedhurinave, nëse grumbullimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur nuk e ka organizuar bashku me sistemin për veprim me automjete të përdorura.

(5) Në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni vepruesi i pavarur dhe vepruesi kolektiv janë të obliguar në program të sigurojnë masa me të cilat pranimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve, nga automjete personale, jo komerciale, të mos i nënshtrohen asnjë shpenzimi për shfrytëzuesit e fundit kur ata i lënë bateritë dhe akumulatorët e hedhur, e as t'u krijojnë kurrfarë obligimi për blerjen e baterive dhe akumulatorëve të rinj.

(6) Vepruesi kolektiv është i obliguar që programin ta hartojë në

bashkëpunim me prodhuesit për bateritë dhe akumulatorët e të cilit janë përfshirë në sistem, si dhe në bashkëpunim me prodhuesit, të kujdeset që programi të mirëmbahet dhe të jetë operativ.

(7) Grumbullimin, trajtimin, riciklimin dhe mënjanimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur, vepruesi i pavarur dhe vepruesi kolektiv mund t'ua ngarkojë vetëm personave juridikë dhe fizikë që posedojnë leje për veprim me hedhurina në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina dhe/ose Ligjin për mjedisin jetësor, edhe këtë ta kryejnë në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me ligj dhe në objekte dhe kapacitet që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj.

(8) Grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur industrialë nga paragrafi (4) i këtij neni, vepruesi kolektiv është i obliguar që t'ia ngarkojë për kryerje personit tjetër juridik ose fizik i cili posedon leje për grumbullim të hedhurinave të rrezikshme në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina.

(9) Me përjashtim nga paragrafi (7) i këtij neni vepruesi kolektiv mund me bashkimin me prodhuesit që janë të përfshirë në sistem të marrë pjesë në aktivitete të lidhura me bateritë dhe akumulatorët e hedhur që kanë të bëjnë ekskluzivisht me grumbullimin e tyre dhe klasifikimin dhe përgatitjen për veprim të mëtutjeshëm të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në kushtet e përcaktuara me Ligjin për menaxhim me hedhurina.

(10) Gjatë përcaktimit të numrit dhe lokacioneve të vendeve për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bartshëm merret parasysh numri i banorëve në vendbanim, me ç'rast sigurohet së paku një vend për grumbullim ose qendër në 1.000 banorë.

(11) Gjatë përcaktimit të numrit dhe lokacioneve të vendeve për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve merret parasysh numri i banorëve në vendbanim, me ç'rast sigurohet së paku një vend për grumbullim ose qendër në 5 000 banorë.

(12) Vendet për grumbullim dhe qendrat nga paragrafët (10) dhe (11) të këtij neni i përfshijnë edhe vendet për grumbullim të locuara te poseduesit dhe tregtarët.

Neni 26

Trajtimi dhe riciklimi

(1) Trajtimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur të grumbulluar së paku përfshin mënjanimin e të gjitha lëngjeve dhe acideve.

(2) Trajtimi, si dhe magazinimi, duke përfshirë edhe magazinimin e përkohshëm në instalimet për trajtim mund të kryhet vetëm në vendet me sipërfaqe të padepërtueshme dhe mbështjellës përkatës rezistues ndaj ujit ose në kontejnerë përkatës.

(3) Riciklimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur duhet të kryhet në atë mënyrë me të cilën do të arrihet:

a) riciklimi i 65% të peshës mesatare të baterive dhe akumulatorëve me acid të plumbit, duke përfshirë edhe riciklimin e përmbajtjes së plumbit deri në shkallën teknike më të lartë të mundshme, me këtë rast duke i shmangur shpenzimet jashtë mase;

b) riciklimi i 75% të peshës mesatare të baterive dhe akumulatorëve me nikël dhe kadmium, duke përfshirë edhe riciklimin e përmbajtjes së kadmiumit deri në shkallën teknike më të lartë të mundshme, me këtë rast duke i shmangur shpenzimet jashtë mase;

v) riciklimi i 50% të peshës mesatare të baterive dhe akumulatorëve tjerë të hedhur.

(4) Nëse bateritë ose akumulatorët grumbullohen bashkë me hedhurina nga pajisja elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e hedhur

ndahen nga hedhurinat e grumbulluara nga pajisja elektrike dhe elektronike.

(5) Vepruesi kolektiv dhe vepruesi i pavarur janë të obliguar bashkë me raportet nga neni 30 i këtij ligji, të parashtrojnë edhe raport për shkallën e efikasitetit të riciklimit që arrihet në çdo vit kalendarik nga paragrafi (3) i këtij neni.

(6) Me qëllim të arritjes së efikasitetit më të madh të riciklimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor me propozim të organit profesional në pajtim me progresin shkencor dhe teknik, mund të miratojë udhëzime që kanë të bëjnë me vendosjen e rregullave të veçanta lidhur me llogaritjen, e cila është e kapshme për publikun, me shkallën e efikasitetit të riciklimit që janë të harmonizuara me teknikat më të mira të kapshme.

(7) Organi profesional është i obliguar që gjatë miratimit të udhëzimit nga paragrafi (6) i këtij neni të kryejë konsultime me palët e interesuara relevante, veçanërisht me prodhuesit, grumbulluesit, kryerësit e riciklimit, subjektet afariste në procesin e përpunimit, organizatat ekologjike, organizatat e konsumatorëve dhe shoqatat e personave të punësuar.

(8) Në rast të eksportimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të cilat nuk mund të përpunohen ose riciklohen në Republikën e Maqedonisë vepruesi kolektiv dhe vepruesi i pavarur mund ta realizojnë në pajtim me rregullat e eksportimit të hedhurinave të rrezikshme.

(9) Në rastet nga paragrafi (8) i këtij neni personi juridik dhe vepruesi i pavarur është i obliguar të dëshmojë se përpunimi dhe riciklimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur në vend të huaj është kryer në pajtim me paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni në formularë të verifikuar për qarkullimin tejkufitar me hedhurina në pajtim me rregullat për import dhe eksport të hedhurinave dhe për këtë të parashtrojë raport në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni.

(10) Bateritë dhe akumulatorët e bartshëm të grumbulluar që përmbajnë kadmium, zhivë ose plumb, personi juridik dhe vepruesi i pavarur mund t'i mënjanojnë në plehërishta ose në magazina nëntokësore, nëse nuk mund të gjendet treg përkatës për shfrytëzimin e tyre përfundimtar, ose nëse mënjanimi i këtyllë paraqet pjesë të programit për lirim me faza nga metalet e rënda e cila i është nënshtruar vlerësimit të ndikimeve ekologjike, ekonomike dhe sociale dhe e cila provon se mundësia për lirim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në këtë mënyrë ka përparësi lidhur me riciklimin.

(11) Për kryerjen e punëve nga paragrafi (10) i këtij neni vepruesi kolektiv dhe vepruesi i pavarur është i obliguar që të parashtrojë kërkesë për miratimin e mënjanimin të organi profesional.

Neni 27

Obligimet për veprim

(1) Vepruesi kolektiv, përkatësisht vepruesi i pavarur është i obliguar që të sigurojë që vendet e grumbullimit dhe qendrat të rregullohen në mënyrën e cila do të mundësojë që shfrytëzuesit e fundit t'i lënë bateritë dhe akumulatorët e hedhur, si dhe të sigurojë marrjen e rregullt të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në afat prej 48 orëve nga momenti i marrjes së njoftimit nga poseduesi ose tregtari se enët dhe vendet për grumbullim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur janë mbushur.

(2) Vepruesi kolektiv, përkatësisht vepruesi i pavarur është i obliguar që në sistemin e vet për veprim të sigurojë vendosjen e posterëve ose mjeteve tjera për informim me të cilat do ta informojë publikun dhe shfrytëzuesit e fundit për punët nga neni 18 paragrafi (5) i këtij ligji.

(3) Vepruesi kolektiv, përkatësisht vepruesi i pavarur në bashkëpunim me komunat, qytetin e Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit është i obliguar në vende përkatëse ta njoftojë publikun për adresat e vendeve për grumbullim dhe qendrave që ekzistojnë në rajonin e asaj komune, në qytetin e Shkupit ose në komunën në Qytetin e Shkupit, që janë të përfshira në sistem, përkatësisht ku kryhet grumbullimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur.

Neni 28

Obligimi për përfshirje në sistemin për veprim

(1) Poseduesi dhe tregtari i cili posedon ose kryen shitje të baterive dhe akumulatorëve është i obliguar të përfshihet në sistemin e veprimit me bateri dhe akumulatorë të hedhur me zbatimin e masave dhe aktiviteteve të përmbajtura në programin nga neni 24 i këtij ligji, që lidhen me:

- sigurimin e hapësirës për vendosjen në enët për grumbullim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bartshëm, ose për lënien e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të aumjeteve dhe industrialë,
- vendosjen e njoftimeve në të cilat përmbahen informatat nga neni 18 paragrafi (5) i këtij ligji dhe informatat nga neni 27 paragrafi (3) i këtij ligji dhe
- realizimin e obligimeve nga neni 16 dhe 17 të këtij ligji dhe obligimet tjera që kanë të bëjnë me poseduesin dhe tregtarin, të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Obligimi nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni nuk ka të bëjë me tregtarët që shesin mall në tregjet e gjelbra ose në tregjet tjera të organizuara të veçanta. Në këtë rast obligimin nga paragrafi (1) alineja 1 e këtij neni, është i obliguar ta përmbushë udhëheqësi i tregjeve të gjelbra ose i tregjeve tjera të organizuara të veçanta.

(3) Poseduesi dhe tregtari, menjëherë pasi të konstatojnë se është mbushur ena me bateri dhe akumulatorë të hedhur e vendosur në vendin për grumbullim, përkatësisht është mbushur hapësira e dedikuar për lënien e tyre, është i obliguar ta njoftojë vepruesin kolektiv ose vepruesin e pavarur, ose personin e tretë të autorizuar nga ana e tyre, me qëllim që të vijë dhe t'i marrë bateritë dhe akumulatorët e hedhur të grumbulluar.

(4) Vepruesi kolektiv me hedhurina nuk mund ta pamundësojë përfshirjen në sistem dhe me këtë zbatimin e programit nga neni 24 i këtij ligji, të prodhuesit i cili kryen importimin e baterive dhe akumulatorëve në Republikën e Maqedonisë, as të kërkojë që prodhuesi të plotësojë kushte tjera që mund të paraqesin barriera tregtare ose prishje të konkurrencës në treg, nëse prodhuesi i plotëson kushtet që vlejnë edhe për prodhuesit e vendit që janë të përfshirë në sistemin e njëjtë.

Neni 29

Obligimet e kryetarit të komunës

(1) Kryetari i komunës, i komunës në qytetin e Shkupit dhe në qytetin Shkup, është i obliguar që :

- të përcaktojë vende për vendosjen e enëve për grumbullim veç e veç të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në rajonin e komunës, komunën në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit dhe
- të organizojë sistem për grumbullimin dhe magazinimin e përkohshëm të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bartshëm dhe dorëzimin e tyre për trajtim, përpunim dhe/ose riciklim.

(2) Punët nga paragrafi (1) i këtij neni, kryetari i komunës, i komunës në qytetin e Shkupit dhe në qytetin e Shkupit i kryen në bashkëpunim me vepruesin kolektiv dhe/ose vepruesin e pavarur me të cilët mund të organizojë grumbullim të veçantë të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në rajonin e komunës, në komunën e qytetit të Shkupit dhe në

qytetin e Shkupit nëpërmjet vendosjes së vendeve për grumbullim dhe qendrave dhe sigurimin e grumbullimit të rregullt të baterive dhe akumulatorëve të hedhur nga vendet për grumbullim dhe qendrat.

(3) Vendet për grumbullim dhe qendrat nga paragrafi (2) i këtij neni mund të vendosen në lokalet e poseduesve ose tregtarëve, në lokalet e institucioneve shkencore arsimore që ekzistojnë në zonën e komunës, në komunën në qytetin e Shkupit dhe në qytetin e Shkupit, në tregjet e gjelbra ose tregjet tjera të organizuara të veçanta, në sipërfaqet publike ose në vendet tjera përkatëse ku pritet që shfrytëzuesit e fundit të lënë bateri dhe akumulatorë të hedhur duke pasur parasysh dendësinë e banorëve.

(4) Obligimet nga paragrafi (1) i këtij neni kryetari i komunës mund t'i realizojë në bazë të marrëveshjes së lidhur me personin juridik kolektiv dhe/ose vepruesin e pavarur.

(5) Me marrëveshjen nga paragrafi (4) i këtij neni veçanërisht rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të palëve të kontraktuara, kushtet dhe mënyra e vendosjes së grumbullimit të veçantë të baterive dhe akumulatorëve të hedhur, mënyra e financimit dhe mbulimi i shpenzimeve, mënyra e informimit të publikut dhe shfrytëzuesve të fundit, si dhe çështje tjera me interes të përbashkët.

(6) Në Programet për menaxhim me hedhurina edhe aktet e komunave, e komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit me të cilat rregullohet çështja për veprimin me hedhurina të përcaktuara në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina, detyrimisht merren parasysh edhe qëllimet për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur nga neni 35 i këtij ligji.

(7) Vendet për grumbullim të vendosur në shkollat fillore dhe të mesme duhet të jenë të dedikuara ekskluzivisht për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të bartshëm.

Neni 30

Obligimet për parashtrimin e raporteve

(1) Vepruesi kolektiv është i obliguar që më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës të organi profesional të parashtrijë raport vjetor për veprimin me bateritë dhe akumulatorët e hedhur nga ana e prodhuesve në emër dhe në llogari të të cilëve është përgjegjës për veprim të drejtë me bateri dhe akumulatorë të hedhur, për vitin paraprak i cili përmban veçanërisht të dhëna për:

- 1) sasinë, llojin, përbërjen dhe madhësinë e baterive dhe akumulatorëve që janë të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë;
- 2) sasinë, llojin, përbërjen dhe madhësinë e baterive dhe akumulatorëve të hedhur që janë grumbulluar;
- 3) sasinë, llojin, përbërjen dhe madhësinë e baterive dhe akumulatorëve të hedhur që janë dorëzuar për trajtim ose riciklim;
- 4) sasinë, llojin, përbërjen dhe madhësinë e baterive dhe akumulatorëve të hedhur që janë trajtuar ose ricikluar, duke përfshirë edhe ato që janë eksportuar për trajtim ose riciklim;
- 5) sasinë dhe përqindjen e realizimit të grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur, lidhur me sasinë që i ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë në vitin paraprak dhe
- 6) sasinë dhe përqindjen e realizimit të qëllimeve nacionale nga neni 35 i këtij ligji.

(2) Vepruesi i pavarur është i obliguar që raportin vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni ta parashtrijë për bateritë dhe akumulatorët e hedhur që vet i ka lëshuar në treg për herë të parë në Republikën e Maqedonisë.

(3) Njoftimi bëhet në mënyrën e përcaktuar në pajtim me nenin 31 të këtij

ligji.

(4) Raporti vjetor nga paragrafi (2) i këtij neni para parashtrimit të organi profesional detyrimisht vërtetohet nga personi tjetër i pa varur juridik i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë përkatëse.

(5) Organi profesional është i obliguar që ta miratojë raportin vjetor nga paragrafi (2) i këtij neni në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit.

(6) Prodhuesi është i obliguar që të mbajë evidencë për sasi të dhe llojet e baterive dhe akumulatorëve që i ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë gjatë një viti kalendarik në formë të shkruar ose elektronike në formular të veçantë dhe për këtë ta njoftojë:

- 1) vepruesin kolektiv në rast kur veprimin me bateritë dhe akumulatorët e hedhur ia ka ngarkuar atij;
- 2) organin profesional kur është i regjistruar si veprues i pavarur;
- 3) organin profesional kur është prodhues i vogël dhe/ose
- 4) organin profesional kur nuk siguron veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur për çfarë e paguan kompensimin nga neni 39 i këtij ligji.

(7) Llogaritja e sasisë së baterive dhe akumulatorëve që janë të lëshuar në tregun e Republikës së Maqedonisë bëhet nëpërmjet grumbullimit të njëhershëm të peshës së baterive dhe akumulatorëve, duke mos i llogaritur bateritë dhe akumulatorët që janë eksportuar nga Republika e Maqedonisë.

(8) Formën dhe përmbajtjen e formularit të raportit vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni dhe mënyrën e parashtrimit të tij, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit nga paragrafi (6) i këtij neni, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët në sferën e mjedisit jetësor.

(9) Njoftimi nga paragrafi (6) i këtij neni parashtrohet më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës.

Neni 31

Parashtrimi i raporteve

(1) Personi juridik dhe fizik i cili për vepruesin kolektiv ose për vepruesin e pavarur kryen grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur është i obliguar që të përpilojë dhe parashtojë raporte për sasi të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të grumbulluar në formular të veçantë.

(2) Personi juridik dhe fizik i cili për vepruesin kolektiv ose për vepruesin e pavarur kryen trajtim dhe riciklim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur është i obliguar që të përgatitë dhe parashtojë raport për sasi të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të marra, trajtuara ose ricikluara në formular të veçantë.

(3) Formën dhe përmbajtjen e formularëve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, si dhe mënyrën e përgatitjes dhe parashtrimit të tyre i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët në sferën e mjedisit jetësor.

(4) Personi juridik dhe fizik i cili kryen përpunimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur është i obliguar të përgatitë dhe të parashtojë raport për shkallën e efikasitetit për riciklimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur i cili arrihet në çdo vit kalendarik, si dhe për atë nëse është plotësuar shkalla e efikasitetit të riciklimit në pajtim me nenin 26 paragrafi (3) i këtij ligji.

(5) Raporti nga paragrafi (4) i këtij neni parashtrohet te organi profesional.

(6) Pjesë përbërëse e formularëve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni

janë edhe formularët për veprim me hedhurina në pajtim me rregullat për menaxhim me hedhurina, si dhe formularët për qarkullim tejkufitar me hedhurina në pajtim me nenin 25 paragrafi (9) i këtij ligji.

(7) Personat që menaxhojnë me vendet për grumbullim dhe qendrat dhe vendet për magazinim të përkohshëm të baterive dhe akumulatorëve të hedhur nuk obligohen për parashtrimin e të dhënave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nëse të njëjtët nuk kryejnë grumbullim, trajtim ose riciklim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur.

(8) Afati për parashtrimin e formularëve nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni rregullohet me marrëveshjen e lidhur ndërmjet vepruesit kolektiv ose vepruesit të pavarur dhe personit juridik ose fizik për kryerjen e punëve për grumbullim, trajtim ose riciklim të baterive dhe akumulatorëve, në mënyrën e cila do të mundësojë respektimin e obligimeve për parashtrimin e raporteve vepruesit kolektiv ose vepruesit të pavarur të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 32

Heqja e lejeve dhe shlyerja nga regjistri

(1) Organi profesional do të fillojë procedurë për heqjen e lejes nga neni 22 i këtij ligji dhe/ose vërtetimi nga neni 23 i këtij ligji vepruesit kolektiv, përkatësisht vepruesit të pavarur, nëse me raportin nga mbikëqyrja e kryer konstatohet se:

- nuk siguron veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur në pajtim me këtë ose ligj tjetër,
- nuk parashtron raport në pajtim me nenin 30 të këtij ligji,
- nuk i përmbushë qëllimet nacionale në pajtim me nenin 35 të këtij ligji dy vjet me radhë në periudhë prej tre vjetësh dhe
- nuk siguron grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të automjeteve në sasi të përcaktuara në pajtim me nenin 40 paragrafi (1) pika 4 të këtij ligji.

(2) Organi profesional do të fillojë procedurë për heqjen e lejes përkatësisht të vërtetimit, nëse me mbikëqyrjen inspektuese të kryer nga inspektori shtetëror për mjedisin jetësor dëshmohet se vepruesi kolektiv ose vepruesi i pavarur grumbullimin, trajtimin dhe mënjanimin e hedhurinave nga bateritë dhe akumulatorët e kryejnë në kundërshtim me këtë ligj dhe rregullat për menaxhim me hedhurina.

(3) Organi profesional do të fillojë procedurë për shlyerjen e prodhuesit nga regjistri i prodhuesve nga neni 12 paragrafi

(4) i këtij ligji, nëse me raportin nga mbikëqyrja e kryer konstatohet se prodhuesi i cili nuk ka siguruar veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur, nuk e ka paguar kompensimin nga neni 39 i këtij ligji për bateritë dhe akumulatorët që i ka lëshuar në treg gjatë një viti.

(4) Organi profesional do të fillojë procedurë për shlyerjen e prodhuesit nga regjistri i prodhuesve nga neni 12 paragrafi (4) i këtij ligji, nëse me raportin nga mbikëqyrja e kryer konstatohet se prodhuesi i cili është i regjistruar si prodhues i vogël i ka tejkualuar sasi të përcaktuara me nenin 20 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 33

Obligime të prodhuesit, poseduesit dhe/ose tregtarit si shfrytëzues të fundit

(1) Prodhuesi, poseduesi dhe/ose tregtari i cili për kryerjen e veprimtarisë ose aktivitetit, vetë importon bateri dhe akumulatorë dhe për këtë nuk ka ndërmjetësues ose furnizues paraprak në Republikën e Maqedonisë, dhe

me këtë njëkohësisht është edhe shfrytëzues i fundit, është i obliguar që për bateritë dhe akumulatorët e hedhur që ai i krijon, të sigurojë veprim me to në mënyrën si vijon:

- të lidhë marrëveshje me vepruesin kolektiv nga neni 22 i këtij ligji i cili në emër dhe në llogari të tij do të sigurojë grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur ose
- në mënyrë të pavarur të veprojë me bateritë dhe akumulatorët e hedhur dhe të sigurojë grumbullimin, përpunimin dhe riciklimin e tyre në pajtim me nenin 23 të këtij ligji.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, prodhuesi, poseduesi dhe/ose tregtari i cili për kryerjen e veprimtarisë ose aktivitetit të tij, vetë importon bateri dhe akumulatorë të aumojeteve dhe industrialë, dhe për këtë nuk ka ndërmjetësues ose furnizues paraprak në Republikën e Maqedonisë, dhe me këtë njëkohësisht është edhe shfrytëzues i fundit, është i obliguar për bateritë dhe akumulatorët e hedhur të automjeteve dhe industrialë që ai i krijon, të sigurojë marrëveshje për marrjen e tyre me personin juridik i cili ka leje përkatëse në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina.

Neni 34

Përjashtime nga veprimi

(1) Prodhuesi i vogël nuk është i obliguar të lidhë marrëveshje me vepruesin kolektiv nga neni 22 i këtij ligji ose të sigurojë leje në pajtim me nenin 23 të këtij ligji, nëse sasia e baterive dhe akumulatorëve që i ka lëshuar në treg ose i importon si shfrytëzues i fundit, nuk i tejkalon sasi të në nivel vjetor të përcaktuara në nenin 20 paragrafi (1) të këtij ligji. .

(2) Përjashtimi nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk e liron prodhuesin e vogël nga realizimi i obligimeve tjera të përcaktuara në këtë ligj për veprim me bateri dhe akumulatorë dhe bateri dhe akumulatorë të hedhur.

V. QËLLIMET NACIONALE PËR GRUMBULLIMIN E BATERIVE DHE AKUMULATORËVE TË HEDHUR

Neni 35

Qëllimet nacionale për grumbullim

(1) Në territorin e Republikës së Maqedonisë, sasi të në vijim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bartshëm duhet të grumbullohen në afatin kohor në vijim, deri në fund të vitit:

- a) 2016, minimum 25% nga pesha e baterive dhe akumulatorëve të bartshëm që janë të lëshuar në treg në territorin e Republikës së Maqedonisë.
- b) 2020, minimum 45% nga pesha e baterive dhe akumulatorëve të bartshëm që janë të lëshuar në treg në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Sasi të e eksportuara të baterive dhe akumulatorëve të bartshëm nga territori i Republikës së Maqedonisë nuk do të llogariten në sasi të nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Sasia e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bartshëm që çdo prodhues i veçantë është i obliguar që ta grumbullojë gjatë vitit rrjedhës për arritjen e qëllimeve nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të jetë e barabartë me pjesën e cila i përgjigjet sasisë së tij vjetore të baterive dhe akumulatorëve që i ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë lidhur me sasinë për të cilën janë përgjegjës të gjithë prodhuesit të cilët kanë lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë bateri dhe akumulatorë.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor mund të përcaktojë përqindje për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të bartshëm për çdo vit në veçanti për arritjen graduale të qëllimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, të harmonizuara paraprakisht me operatorët ekonomikë.

(5) Qëllimet nga paragrafi (1) i këtij neni Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor mund t'i revidojë sipas nevojës, e së paku një herë në tri vjet, në pajtim me programin nga neni 36 i këtij ligji.

(6) Në sasi të nga paragrafi (1) i këtij neni llogariten edhe bateritë dhe akumulatorët e bartshëm që janë të instaluar në aparatet ose në pajisjen elektrike dhe elektronike.

(7) Organi profesional e ndjek realizimin e shkallëve të grumbullimit në nivel vjetor në bazë të të dhënave të fituar në pajtim me nenet 30 dhe 31 të këtij ligji.

(8) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton mënyrën e ndjekjes dhe të llogaritjes së realizimit të shkallëve për grumbullim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit për ndjekje dhe llogaritje.

Neni 36

Programi për menaxhim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur

(1) Për arritjen e qëllimeve nacionale të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji dhe plotësimin e sasive nga neni 40 paragrafi (1) pika 4 e këtij ligji, me propozim të organit profesional, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e miraton Programin për menaxhim me bateri dhe akumulatorë të hedhur (në tekstin e mëtejshëm: Programi).

(2) Programi miratohet për periudhë prej së paku pesë vjet dhe përmban veçanërisht:

- përkrahje dhe vlerësim të gjendjes ekzistuese në menaxhimin me bateritë dhe akumulatorët e hedhur,
- përkrahje të subjekteve që veprojnë me bateritë dhe akumulatorët e hedhur,
- sasinë dhe llojin e baterive dhe akumulatorëve që lëshohen në treg në Republikën e Maqedonisë, si dhe parashikimet e ardhshme dhe trendin e zhvillimit në periudhën e ardhshme pesëvjeçare,
- masat për nxitjen e grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur,
- masat për nxitjen e hulumtimit dhe përmirësimet në aspekt të karakteristikave të përgjithshme ekologjike të baterive dhe akumulatorëve gjatë ciklit të tyre të përgjithshëm jetësor,
- masat për zhvillim dhe marketing të baterive dhe akumulatorëve që përmbajnë sasi më të vogla të substancave të rrezikshme, ose që përmbajnë më pak substanca ndotëse, veçanërisht si zëvendësim për zhivën, kadmiumin dhe plumbin,
- masat me qëllim të ndihmës së zhvillimit të teknologjive të reja për riciklim, trajtim dhe përpunim dhe nxitjes së hulumtimeve të metodave ekologjike dhe rentabile për riciklimin e të gjitha llojeve të baterive dhe akumulatorëve,
- masat për përkrahjen e kapaciteteve për trajtim dhe përpunim me qëllim të vendosjes së programit të certifikuar për menaxhim ekologjik që kanë të bëjnë me skemat e menaxhimit me mjedisin jetësor dhe për revizion (EMAS),

- masat për pengimin e krijimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur,
- masat për nxitjen e shkallës së grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur,
- masat për përmirësimin e gjendjes në tregun për trajtim, përpunim dhe riciklim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur,
- masat për zvogëlimin e pranisë së substancave të rrezikshme në bateri dhe akumulatorë,
- masat ekonomike,
- masat për edukim dhe realizim të fushatës për ngritjen e vetëdijes publike për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur,
- pasqyrë të rregullativës ligjore për menaxhim me bateri dhe akumulatorë të hedhur dhe masat për përmirësimin e saj,
- udhëzime për zhvillimin e ardhshëm të menaxhimit me bateri dhe akumulatorë të hedhur,
- qëllimet e sasive të baterive dhe akumulatorëve të hedhur që duhet të grumbullohen, trajtohen dhe/ose përpunohen në periudhën e ardhshme dhe
- çështje tjera që janë me rëndësi për menaxhimin me bateri dhe akumulatorë.

(3) Programi hartohet me pjesëmarrjen e subjekteve që veprojnë me bateri dhe akumulatorë të hedhur, organeve të pushtetit shtetëror dhe lokal, organizatave joqeveritare dhe institucioneve tjera publike dhe shkencore.

Neni 37

Marrëveshja vullnetare

(1) Operatorët ekonomikë mund t'i qasen lidhjes së marrëveshjes vullnetare me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nëpërmjet të cilës do t'i rregullojnë obligimet dhe të drejtat e ndërsjella për zbatimin e programit për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur nga neni 24 i këtij ligji, informimin e shfrytëzuesve të fundit për veprimin me bateritë dhe akumulatorët e hedhur, arritjen e qëllimeve më të mëdha nga ato të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji, arritjen e sasive më të mëdha nga ato të përcaktuara në nenin 40 paragrafi (1) pika 4 të këtij ligji dhe/ose arritjen e qëllimeve nga neni 2 i këtij ligji.

(2) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni detyrimisht i rregullon çështjet në vijim:

- afatin e vlefshmërisë,
- qëllimet dhe afatin për arritjen e tyre,
- mënyrën e ndjekjes së realizimit të qëllimeve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshje,
- obligimet dhe të drejtat e operatorëve ekonomikë dhe të organeve kompetente të pushtetit shtetëror,
- kushtet dhe mënyrat për ndjekjen e përmbushjes së obligimeve të përcaktuara në marrëveshje,
- masat, mënyrën e ndërmarrjes së masave dhe penaltitë që mund të zbatohen në rast të mospërmbushjes së obligimeve të përcaktuara në marrëveshje dhe
- kushtet dhe mënyrën e ndërprerjes së obligimeve dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve.

(3) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(4) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe mënyra dhe rezultatet nga zbatimi i saj janë të kapshme për publikun.

Neni 38

Baza e të dhënave dhe sistemi informativ

(1) Organi profesional është i obliguar që të vendosë dhe të udhëheqë bazë të të dhënave për bateritë dhe akumulatorët që lëshohen në treg në Republikën e Maqedonisë.

(2) Baza mbahet në bazë të të dhënave nga raportet e parashtruara në pajtim me nenin 30 dhe 31 të këtij ligji dhe i përmban veçanërisht të dhënat në vijim për:

- 1) sasinë dhe llojin e baterive dhe akumulatorëve që janë të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë;
- 2) sasinë dhe llojin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur që janë grumbulluar;
- 3) sasinë dhe llojin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur që janë trajtuar, përpunuar ose ricikluar;
- 4) sasinë dhe përqindja e realizimit të qëllimeve nacionale nga neni 35 i këtij ligji dhe sasinë nga neni 40 paragrafi (1) pika 4 e këtij ligji dhe
- 5) pasqyrën e përgjithshme të veprimit me bateritë dhe akumulatorët e hedhur.

(3) Në bazë të të dhënave nga paragrafi (2) i këtij neni, organi profesional më së voni deri më 30 maj në vitin rrjedhës publikon raport në të cilin përshkruhet gjendja me menaxhimin me bateritë dhe akumulatorët që lëshohen në treg në Republikën e Maqedonisë në tri vjetët e fundit.

(4) Bashkë me raportin nga paragrafi (3) i këtij neni, organi profesional publikon të dhëna për realizimin e programit nga neni 36 i këtij ligji, si dhe të dhëna për sistemet ekzistuese për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur.

(5) Në raportin nga paragrafi (3) i këtij neni, organi profesional paraqet të dhëna për të gjitha masat që janë ndërmarrë me qëllim të që zvogëlohet ndikimi mbi mjedisin jetësor i baterive dhe akumulatorëve, veçanërisht për masat të cilat kanë të bëjnë me:

- a) zhvillimin, duke i përfshirë masat vullnetare që i ndërmarrin prodhuesit, me qëllim të zvogëlimit të sasive të metaleve të rënda dhe substancave tjera të rrezikshme të përmbajtura në bateritë dhe akumulatorët;
- b) teknikat e reja të riciklimit dhe trajtimit;
- v) pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në programet për menaxhim me mjedisin jetësor;
- g) hulumtimin në sferat e theksuara dhe
- d) promovimin e zvogëlimit të hedhurinave.

(6) Të dhënat e grumbulluara në bazë të këtij neni përpunohen dhe validohen nga ana e Qendrës Informative Maqedonase për Mjedisin Jetësor në Sistemin informativ për bateri dhe akumulatorë të hedhur, që është pjesë përbërëse e Sistemit informativ për mjedisin jetësor.

(7) Të dhënat e përpunuara dhe të validuara nga paragrafi (6) i këtij neni dorëzohen te trupat dhe organet kompetente të Komisionit Evropian dhe ato janë të kapshme për publikun.

Neni 39

Instrumentet ekonomike

(1) Prodhuesi i cili për herë të parë lëshon në treg në Republikën e Maqedonisë bateri dhe akumulatorë, si dhe prodhuesi, poseduesi dhe tregtari i cili si shfrytëzues i fundit importon në Republikën e Maqedonisë bateri dhe akumulatorë, është i obliguar të paguajë kompensim për menaxhim me bateri dhe akumulatorë të hedhur (në tekstin e mëtejme: kompensim).

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni është: lloji i prodhimit Shuma

- 1) bateri dhe akumulatorë të bartshëm 120,00 den/kg
- 2) bateri dhe akumulatorë plumbi të automjeteve dhe industrialë 0,9 den/kg

3) bateri dhe akumulatorë tjerë pa plumb të automobilëve dhe industrialë 8,5 den/kg

(3) Kompensimi llogaritet në bazë të rëndësisë-neto të baterive dhe akumulatorëve.

(4) Obligimi për llogaritjen e kompensimit krijohet në momentin kur për herë të parë prodhuesi lëshon në treg në Republikën e Maqedonisë bateri dhe akumulatorë.

(5) Obligimi për llogaritjen e kompensimit për prodhuesin, poseduesin dhe tregtarin i cili si shfrytëzues i fundit importon në Republikën e Maqedonisë bateri dhe akumulatorë me shfrytëzimin e të cilëve krijon bateri dhe akumulatorë të hedhur krijohet në momentin kur e ka filluar shfrytëzimin e tyre.

(6) Prodhuesi, poseduesi dhe tregtari i cili si shfrytëzues i fundit importon bateri dhe akumulatorë është i obliguar që ta paguajë kompensimin nga paragrafi (2) i këtij neni në llogarinë përkatëse për pagesë në kuadër të llogarisë së trezorit në çdo 15 ditë në muajin rrjedhës për të gjitha kompensimet e llogaritura nga muaji paraprak.

(7) Kompensimi nuk paguhet, nëse bateritë dhe akumulatorët eksportohen.

(8) Në rastin nga paragrafi (7) i këtij neni, prodhuesi, poseduesi dhe tregtari i cili si shfrytëzues i fundit importon bateri dhe akumulatorë, është i obliguar të sigurojë doganore për eksport si dëshmi se sasia e baterive dhe akumulatorëve, për të cilën nuk është llogaritur kompensimi nga paragrafi (2) i këtij neni, është eksportuar nga Republika e Maqedonisë.

(9) Në rast të eksportit të baterive dhe akumulatorëve për të cilët paguhet kompensimi i përcaktuar në këtë nen, për të cilët paraprakisht është paguar kompensimi nga paragrafi (2) i këtij neni, prodhuesi, poseduesi dhe tregtari i cili si shfrytëzues i fundit importon bateri dhe akumulatorë, kanë të drejtë të kthimit të kompensimit të paguar për sasinë e eksportuar në bazë të aktvendimit të lëshuar nga organi profesional.

(10) Kundër aktvendimit nga paragrafi (9) i këtij neni pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrijë ankesë te ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(11) Mjetet nga kompensimi nga paragrafi (2) i këtij neni janë të hyra në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

(12) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e financave e përcakton mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për kthimin e kompensimit në rastet nga paragrafi (9) i këtij neni.

Neni 39-a

Obligimi për mënyrën e llogaritjes, pagimit si dhe për mbajtjen e evidencës për kompensimin e llogaritur dhe të paguar

(1) Prodhuesi që lëshon në treg bateri dhe akumulatorë dhe prodhuesi, poseduesi dhe tregtari i cili si shfrytëzues përfundimtar importon bateri dhe akumulatorë (në tekstin e mëtejshëm: obliguesi) detyrohet që kompensimin nga neni 39 paragrafi (2) i këtij ligji në kohë dhe në mënyrë të rregullt ta llogarisë dhe ta paguajë, si dhe të mbajë, mirëmbajë dhe ruajë evidencë të rregullt dhe të saktë për kompensimin e llogaritur dhe të paguar.

(2) Në bazë të evidencës nga paragrafi (1) i këtij neni, obliguesi përpilon dhe në çdo tre muaj dorëzon te organi profesional, llogaritje për kompensimin e paguar në formular të veçantë.

(3) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin e Financave, i përcakton mënyrën dhe procedurën për mbajtjen, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e evidencës nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit nga paragrafi (2) i këtij neni

Neni 40

Lirimi nga pagesa e kompensimit

(1) Nga pagesa e kompensimit nga neni 39 paragrafi (2) i këtij ligji lirohen:

- 1) prodhuesi, poseduesi dhe tregtari i cili si shfrytëzues i fundit importon bateri dhe akumulatorë ka lidhur marrëveshje për marrjen e obligimeve për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur me personin juridik i cili ka siguruar leje në pajtim me nenin 22 paragrafi (8) të këtij ligji;
- 2) prodhuesi, poseduesi dhe tregtari i cili si shfrytëzues i fundit importon bateri dhe akumulatorë ka siguruar vërtetim se prodhuesi është i regjistruar si veprues i pavarur në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të këtij ligji;
- 3) prodhuesi i cili është i përcaktuar si prodhues i vogël në pajtim me nenin 20 të këtij ligji dhe
- 4) prodhuesi, poseduesi dhe tregtari i cili si shfrytëzues i fundit importon bateri dhe akumulatorë të automjeteve nuk siguron, si veprues i pavarur ose nëpërmjet vepruesit kolektiv, grumbullimin e së paku 80 % nga sasia vjetore e baterive dhe akumulatorëve të automjeteve që i ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë.

(2) Prodhuesi, poseduesi dhe tregtari i cili si shfrytëzues i fundit importon bateri dhe akumulatorë nga paragrafi (1) pika 1 e këtij neni janë të liruar nga pagesa e kompensimit nga neni 39 paragrafi (2) i këtij ligji, nëse posedon vërtetim nga neni 22 paragrafi (8) i këtij ligji.

(3) Formën dhe përmbajtjen e formularit të vërtetimit nga paragrafi (2) i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheqë me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, kompensimin nga neni 39 paragrafi (2) i këtij ligji, vepruesi kolektiv ose vepruesi i pavarur, e paguajnë në shumë të dyfishtë, nëse:

- 1) vepruesi kolektiv ose vepruesi i pavarur nuk parashtron raport në pajtim me nenin 30 të këtij ligji;
- 2) organi profesional nuk e miraton raportin në pajtim me nenin 30 paragrafi (5) të këtij ligji, për mospërmbushjen e qëllimeve nacionale të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji ose nuk është siguruar grumbullim i baterive dhe akumulatorëve të automjeteve në sasi të përcaktuara në pajtim me nenin 40 paragrafi (1) pika 4 të këtij ligji. në këtë rast kompensimi paguhet vetëm për dallimin ndërmjet qëllimeve nacionale të përcaktuara në pajtim me nenin 35 të këtij ligji, përkatësisht sasi të përcaktuara në pajtim me nenin 40 paragrafi (1) pika 4 të këtij ligji dhe qëllimet e arritura, përkatësisht sasi në pajtim me raportin vjetor dhe/ose konstatimin e organit profesional dhe
- 3) është parashtruar raport vjetor i pasaktë në pajtim me nenin 30 të këtij ligji në lidhje me llojin dhe sasinë e baterive dhe akumulatorëve që i ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë ose i ka importuar si shfrytëzues i fundit.

(5) Për rastet nga paragrafi (4) i këtij neni organi profesional miraton aktvendim.

(6) Kundër aktvendimit nga paragrafi (5) i këtij neni pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrorë ankesë te ministri i cili udhëheq me organin e

administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(7) Në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni, kompensimi i dyfishtë llogaritet sipas lartësisë së kompensimit, të përcaktuar në nenin 39 paragrafi (2) të këtij ligji, në përpjesëtim me pjesëmarrjen e llojit dhe sasinë e baterive dhe akumulatorëve që janë të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë.

Neni 41

Shfrytëzimi i kompensimit dhe Programi për financim

(1) Mjetet e grumbulluara nga kompensimi nga neni 39 paragrafi (2) i këtij ligji shfrytëzohen për zbatimin e masave dhe aktiviteteve që janë të përcaktuara në Programin për menaxhim me bateri dhe akumulatorë të hedhur nga neni 36 i këtij ligji.

(2) Financimi dhe realizimi i masave dhe aktiviteteve nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet në bazë të programit vjetor për financim që organi profesional e përgatit në bazë të programit nga neni 36 i këtij ligji.

(3) Programin vjetor për financim e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Ndarja e mjeteve nga programi nga paragrafi (3) i këtij neni, kryhet nëpërmjet konkursit publik.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, një pjesë e mjeteve nga programi nga paragrafi (3) i këtij neni, mund të ndahen edhe me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, nëse mjetet janë të dedikuara për përmbushjen e obligimeve që janë të përcaktuara në marrëveshjet vullnetare nga neni 37 i këtij ligji.

Neni 42

Konkursi publik

(1) Konkursi publik nga neni 41 paragrafi (4) i këtij neni realizohet nga komisioni i formuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni është i përbërë prej pesë anëtarëve prej të cilëve:

- njëri është përfaqësues i organit profesional,
- njëri është përfaqësues i vepruesit kolektiv nga neni 22 i këtij ligji,
- njëri është përfaqësues i vepruesit të pavarur nga neni 23 i këtij ligji,
- një përfaqësues nga tregtarët që bëjnë shitjen e baterive dhe akumulatorëve në Republikën e Maqedonisë dhe
- një përfaqësues i personave juridikë që kryejnë grumbullim, trajtim dhe/ose përpunim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur.

(3) Konkursi publik nga neni 41 paragrafi (4) i këtij ligji shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në së paku dy gazeta ditore që botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

(4) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni është i obliguar të marrë vendim për shpërndarjen e mjeteve në afat prej 30 ditësh nga dita e skadimit të afatit nga paragrafi (4) i këtij neni.

(5) Rezultatet nga konkursi shpallen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 42-a

(1) Nëse Komisioni nga neni 42 paragrafi (1) i këtij ligji, pas konkursit të shpallur publik dhe afatit të përcaktuar në nenin 42 paragrafi (4) të këtij ligji, nuk përcakton propozim për ndarje të mjeteve, përkatësisht nuk miraton akt për moskryerje të zgjedhjes, pjesëmarrësi i konkursit publik ka të drejtë që në afat prej tri ditësh pune nga kalimi i këtij afati të paraqesë kërkesë te sekretaria e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, për marrje vendimi për ndarje të mjeteve pas konkursit të shpallur publik nga neni 42 paragrafi (4) të këtij ligji. Nëse ministri nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Formën dhe përmbajtjen e formularit nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Më kërkesë nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrues i kërkesës parashtron kopje të kërkesës për ndarje të mjeteve nëpërmjet konkursit publik.

(4) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, për marrje të aktvendimit me të cilin kërkesa për ndarje të mjeteve nëpërmjet konkursit publik, pranohet ose refuzohet.

(5) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(6) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në përputhshmëri me ligjin, dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informojë parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(7) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer sipas ligjit miraton aktvendim, me të cilin e obligon ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor që në afat prej dhjetë ditëve të vendosë për kërkesën e paraqitur, përkatësisht ta pranojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzon kopje të aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(8) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afatin nga paragrafi (7) i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ, dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, do të vendosë për kërkesën e paraqitur për çfarë në afatin e njëjtë do ta informojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(9) Nëse ministri nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë

kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në këtë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(10) Nëse inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të paraqesë kundërshtim te sekretaria e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa paraqitet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (10) i këtij neni dhe nëse vërteton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit të parashtruesit të kërkesës sipas paragrafëve (6) dhe (7) të këtij neni dhe/ose nuk paraqet kallëzim në përputhshmëri me paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin, dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në përputhshmëri me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(12) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Në rastin nga paragrafi (12) i këtij neni drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(14) Në rastin nga paragrafi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në përputhshmëri me paragrafin (11) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(16) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(17) Procedura para Gjykatës Administrative është urgjente.

VI. MBIKËQYRJA

Neni 43

(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullave e miratuara në bazë të këtij ligji, kryen organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, kryen Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor.

(3) Mbikëqyrje mbi raportet e parashtruar në pajtim me nenin 30 dhe 31 të këtij ligji kryen organi profesional.

(4) Për punët në kompetencë të komunave, të komunave në qytetin e

Shkupit dhe të qytetit të Shkupit të përcaktuara në këtë ligj, mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin dhe aplikimin e këtij ligji, kryejnë inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunave, inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunave të qytetit të Shkupit dhe inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të qytetit të Shkupit.

(5) Mbikëqyrje inspektuese mbi realizimin dhe zbatimin e këtij ligji lidhur me shënimin e baterive dhe akumulatorëve dhe posedimin e enëve për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur te tregtarët, si dhe lidhur me njoftimin e konsumatorëve, kryen Inspektorati Shtetëror i Tregut.

(6) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji në pjesën e veprimit joligjor me bateritë dhe akumulatorët e hedhur nga ana e qytetarëve dhe lënia ose dorëzimi i tyre si hedhurina të komunaleve, kryejnë inspektorët e komunalieve dhe inspektorët e autorizuar të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit.

Neni 43-a

Mbikëqyrja e kompensimit të llogaritur dhe të paguar

(1) Mbikëqyrje të kompensimit të llogaritur dhe të paguar, lirimin nga pagesa e kompensimit, si dhe respektimit të afateve për pagimin e kompensimeve, e kryen Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, përmes inspektorëve shtetërorë për mjedis jetësor.

(2) Për mbikëqyrjen e kryer nga paragrafi (1) i këtij neni inspektori shtetëror i mjedisit jetësor merr aktvendim.

(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtojë ankesë te ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Në rast kur me aktvendimin nga paragrafi (2) i këtij neni, që është përfundimtar në procedurë administrative, përcaktohet kthimi i kompensimit të paguar, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor detyrohet që aktvendimin ta dorëzojë te Ministria e Financave për zbatimin e tij.

(5) Në rast kur me aktvendimin nga paragrafi (2) i këtij neni, që është përfundimtar në procedurë administrative, është përcaktuar se obliguesi duhet të paguajë kompensim, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor detyrohet që aktvendimin ta dorëzojë te obliguesi.

Neni 44

(1) Inspektori shtetëror, përkatësisht inspektori i autorizuar, përkatësisht organi tjetër i administratës shtetërore që e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, është i obliguar të mbajë evidencë për mbikëqyrjet dhe inspektimet e kryera te personat juridikë dhe fizikë për të cilët përpilon raport kuartal dhe atë e publikon në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, përkatësisht në ueb faqen e komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit, përkatësisht në ueb faqen e organit tjetër të administratës shtetërore që e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(2) Inspektorët shtetërorë të mjedisit jetësor, inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, inspektorët shtetërorë të tregut, inspektorët e komunalieve të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji, mund të kërkojnë bashkëpunim nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme.

Neni 44-a

Veprimi për fletëparaqitje nga personi fizik ose juridik

(1) Inspektorët shtetërorë të mjedisit jetësor, inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, inspektorët komunalë të komunaleve, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe inspektorët shtetëror të tregut, kanë për detyrë që në afat prej shtatë ditësh të veprojnë për iniciativë ose fletëparaqitje për ngritje të procedurës inspektuese.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektorët shtetërorë të mjedisit jetësor, inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, inspektorët komunalë të komunaleve, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe inspektorët shtetëror të tregut, kanë për detyrë që ta njoftojnë parashtruesin e iniciativës ose fletëparaqitjes për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në afat prej shtatë ditësh nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

Neni 45

Fushëveprimi i mbikëqyrjes së inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i vet inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, ka të drejtë të:

1) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse bateritë dhe akumulatorët kanë prani të metaleve të rënda në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji;

2) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse bateritë dhe akumulatorët e hedhur veprohet në kundërshtim me nenin 9 të këtij ligji;

3) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse personat juridikë dhe fizikë që lëshojnë bateri dhe akumulatorë në treg në Republikën e Maqedonisë janë të regjistruar në pajtim me nenin 12 të këtij ligji;

4) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse personat juridikë dhe fizikë i lënë bateritë dhe akumulatorët e hedhur në vende të shënuara për këtë qëllim (neni 14);

5) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse personat juridikë dhe fizikë si shfrytëzues të fundit bateritë dhe akumulatorët e hedhur i grumbullojnë dhe i ruajnë ndaras (neni 15 paragrafët (1) dhe (2));

6) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse poseduesi dhe tregtari i pranon bateritë dhe akumulatorët e hedhur të bartshëm të dorëzuar nga ana e shfrytëzuesve të fundit në pajtim me nenin 16 të këtij ligji;

7) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse poseduesi ka enë të vendosura për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur dhe njoftim për mënyrën e grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur (neni 17 paragrafët (1) dhe (4));

8) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse poseduesi dhe tregtari ua dorëzojnë bateritë dhe akumulatorët e grumbulluar personave të autorizuar për grumbullim (neni 17 paragrafi (5));

9) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse prodhuesi i ka përmbushur obligimet që dalin nga neni 18 i këtij ligji;

10) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse prodhuesit sigurojnë grumbullim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në pajtim me nenin 19 të këtij ligji;

11) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse janë përmbushur kushtet për lirim (neni 20);

12) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse prodhuesi në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet personit kolektiv vepron me bateritë dhe akumulatorët (neni 21 paragrafi (1));

13) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse vepruesi kolektiv posedon leje në pajtim me nenin 22 të këtij ligji;

- 14) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse prodhuesi i cili vepron në mënyrë të pavarur me bateritë dhe akumulatorët e hedhur posedon leje në pajtim me nenin 23 të këtij ligji;
- 15) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse grumbullimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur industrialë i është ngarkuar personit juridik ose fizik i cili posedon leje për grumbullimin e hedhurinave të rrezikshme në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina (neni 25 paragrafi (8));
- 16) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse numri i lokacioneve të vendeve për grumbullim dhe qendrave për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të bartshëm i përgjigjen kushtit për vendosjen e një vendi për grumbullim ose qendre ekuivalente me 1000 banorë (neni 25 paragrafi (10));
- 17) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse numri i lokacioneve të vendeve për grumbullim dhe qendrave për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve i përgjigjen kushtit për vendosjen e një vendi për grumbullim ose qendre ekuivalente me 5000 banorë (neni 25 paragrafi (11));
- 18) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse trajtimi dhe riciklimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur kryhet në pajtim me nenin 26 të këtij ligji;
- 19) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse është parashtruar raport për shkallën e efikasitetit të riciklimit që arrihet në çdo vit kalendarik (neni 26 paragrafi (5));
- 20) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse përmbushen obligimet për veprim në pajtim me nenin 27 të këtij ligji;
- 21) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse poseduesi dhe tregtari i cili, posedon, ose kryen shitje të baterive dhe akumulatorëve ka vendosur enë për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur, ka vendosur njoftime në të cilat përmbahen informata për veprim dhe i realizojnë obligimet e veta për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur (neni 28);
- 22) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse parashtrohen raporte në pajtim me nenin 30 dhe 31 të këtij ligji;
- 23) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse prodhuesi, poseduesi dhe/ose tregtari i cili për kryerjen e veprimtarisë ose aktivitetit të vet, vetë importon bateri dhe akumulatorë dhe për këtë nuk ka ndërmjetësues ose shpërndarës paraprak në Republikën e Maqedonisë vepron në pajtim me nenin 33 të këtij ligji;
- 24) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse dokumentet dhe të dhënat me të cilat vërtetohet se janë përmbushur qëllimet nacionale nga neni 35 i këtij ligji janë autentike;
- 25) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse janë përmbushur obligimet që dalin nga marrëveshjet vullnetare (neni 37) dhe
- 26) kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse përmbushen obligimet dhe kushtet për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur që janë të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Nëse inspektori shtetëror i mjedisit jetësor gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese përcakton se:

1) grumbullimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur industrialë i është ngarkuar personit juridik ose fizik i cili nuk posedon leje për grumbullimin e hedhurinave të rrezikshme në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina (neni 25 paragrafi (8)), përkohësisht do t'i konfiskojë bateritë dhe akumulatorët që janë grumbulluar.

(3) Për konfiskimin e kryer të baterive dhe akumulatorëve nga paragrafi (2) i këtij neni inspektori shtetëror i mjedisit jetësor jep vërtetim.

(4) Me kërkesë të inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese mund të marrë pjesë edhe nëpunësi shtetëror i punësuar në organin profesional.

(5) Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor është i obliguar të kryejë mbikëqyrje inspektuese kur këtë e ka kërkuar organi profesional.

Neni 46

Miratimi i aktvendimeve të inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese mbi personat juridikë dhe fizikë, inspektori i mjedisit jetësor, me aktvendim do:

1) ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditë, nëse bateritë dhe akumulatorët kanë metale të rënda në kundërshtim me atë që është përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji dhe do të përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë, në të cilin duhet t'i mënjanojë pasojat dhe për këtë do ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror të Tregut (neni 8);

2) ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 120 ditë, nëse me bateritë dhe akumulatorët e hedhur veprohet në kundërshtim me nenin 9 të këtij ligji;

3) t'i obligojë të regjistrohen në pajtim me nenin 12 të këtij ligji;

4) t'i obligojë që bateritë dhe akumulatorët e hedhur t'i lënë në vendet e shënuara për atë dedikim dhe do të përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë mangësitë e përcaktuara (neni 14);

5) t'i obligojë që bateritë dhe akumulatorët e hedhur t'i ruajnë ndaras dhe do të përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë mangësitë e përcaktuara (neni 15);

6) t'i obligojë që të veprojnë në pajtim me nenin 16 të këtij ligji;

7) t'i obligojë që t'i përmbushin kushtet nga neni 17 i këtij ligji dhe do të përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë mangësitë e përcaktuara;

8) t'i obligojë që t'i përmbushin obligimet nga neni 18 dhe 19 i këtij ligji dhe do të përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë mangësitë e përcaktuara;

9) ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditë, nëse nuk kanë lidhur marrëveshje për marrjen e obligimeve për veprim me bateri dhe akumulatorë të hedhur me vepruesin kolektiv ose vetë nuk vepron me ato si veprues i pavarur (neni 21);

10) ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditë, nëse vepruesi kolektiv nuk posedon leje nga neni 22 paragrafi (2) i këtij ligji;

11) ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditë, nëse vepruesi i pavarur nuk posedon leje nga neni 23 i këtij ligji;

12) ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditë, nëse nuk kanë përpiluar program në pajtim me nenin 24 të këtij ligji dhe do t'i obligojë që në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë ta përpilojnë programin;

13) ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditë, nëse nuk janë përmbushur kushtet dhe nuk realizohen kushtet e parapara në programin nga neni 24 dhe do t'i obligojë që në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë t'i mënjanojnë mangësitë;

14) ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditë, nëse grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur industrialë e kryen personi juridik ose personi fizik i cili nuk posedon leje për grumbullimin e hedhurinave të rrezikshme në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina (neni 25 paragrafi (8));

15) ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditë, nëse numri i lokacioneve të vendeve për grumbullim nuk janë në pajtim me nenin 25 paragrafët (10) dhe (11) të këtij ligji dhe do t'i obligojë që në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë t'i mënjanojnë mangësitë;

16) t'i obligojë që trajtimi dhe riciklimi të zhvillohet në pajtim me nenin 26 të këtij ligji;

17) t'i obligojë që t'i përmbushin obligimet nga neni 27 i këtij ligji dhe do të përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 90 ditë që t'i mënjanojnë mangësitë;

18) ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 15 ditë, nëse nuk janë përmbushur obligimet nga neni 28 i këtij ligji;

19) ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90

ditë, nëse nuk janë parashtruar raportet nga nenet 30 dhe 31 të këtij ligji dhe të përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 90 ditë që t'i mënjanojnë mangësitë;

20) të propozojë fillimin e procedurës për heqjen e lejes nga neni 22 dhe të vërtetimit nga neni 23 i këtij ligji dhe do të propozojë fillimin e procedurës për shlyerjen nga regjistri nga neni 12 i këtij ligji, nëse konstaton se janë përmbushur kushtet nga neni 32 i këtij ligji;

21) t'i obligojë që t'i përmbushin obligimet nga neni 33 i këtij ligji dhe do të përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 90 ditë, që t'i mënjanojnë mangësitë;

22) t'i obligojë që të marrin masa për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur, nëse nuk janë arritur qëllimet nacionale nga neni 35 i këtij ligji;

23) t'i obligojë që të marrin masa për përmbushjen e obligimeve të përcaktuara në marrëveshjen vullnetare (neni 37) dhe

24) t'i obligojë që të marrin masa për përmbushjen e kushteve dhe obligimeve të përcaktuara në këtë ligj.

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor konstaton se: subjektet që menaxhojnë me bateritë dhe akumulatorët e hedhur nuk u përmbahen ligjeve dhe rregullave tjera, rregullave teknike, standardeve, rekomandimeve dhe akteve tjera të përgjithshme, me procesverbal do t'i konstatojë parregullsitë e përcaktuara dhe në aktvendim do ta përcaktojë afatin në të cilin do të duhet të mënjanohen.

(3) Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk veprojnë në pajtim me aktvendimin e inspektorëve shtetërorë të mjedisit jetësor dhe nuk i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar të përcaktuara me aktvendim, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor do të parashtrorë Kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para organit kompetent.

(4) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor, mund të paraqitet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(5) Për kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni inspektori shtetëror i mjedisit jetësor ka të drejtë për marrjen edhe të masave tjera të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor dhe Ligjin për menaxhim me hedhurina.

Neni 47

Fushëveprimi i mbikëqyrjes së inspektorëve të autorizuar të mjedisit jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe të inspektorëve komunalë të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i vet inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe inspektorët komunalë të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, kanë të drejtë:

1) të kryejnë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojnë nëse bateritë dhe akumulatorët e hedhur lihen në vende që nuk janë të shënuara për atë dedikim (nenet 14 dhe 15) dhe

2) të kryejnë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojnë nëse vepruesi kolektiv dhe/ose vepruesi i pavarur e ka organizuar grumbullimin e

veçantë të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në rajonin e komunës, të komunës në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit nëpërmjet vendosjes së vendeve për grumbullim dhe qendrave dhe e ka siguruar grumbullimin e rregullt të baterive dhe akumulatorëve të hedhur nga vendet për grumbullim dhe qendrat në pajtim me marrëveshjet e lidhura (neni 29).

Neni 48

Miratimi i aktvendimeve të inspektorëve të autorizuar të mjedisit jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe të inspektorëve komunalë të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe inspektorët komunalë të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejshëm: inspektori i autorizuar), personat juridikë dhe fizikë, me aktvendim:

1) do t'i obligojë që bateritë dhe akumulatorët e hedhur t'i lënë në vende të shënuara për atë dedikim dhe do t'u përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë në të cilin duhet t'i mënjanojnë pasojat (nenet 14 dhe 15) dhe

2) do t'i obligojë që të marrin masa me qëllim të përmbushjes së obligimeve të përcaktuara në marrëveshje dhe do t'u përcaktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 90 ditë në të cilin duhet t'i mënjanojnë pasojat (neni 29).

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i autorizuar konstaton se subjektet që menaxhojnë me bateritë dhe akumulatorët e hedhur nuk u përmbahen ligjeve dhe rregullave tjera, rregullave teknike, standardeve, rekomandimeve dhe akteve tjera të përgjithshme, me procesverbal do t'i përcaktojë parregullsitë e përcaktuara dhe në aktvendim do ta përcaktojë afatin në të cilin duhet të mënjanohen.

(3) Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk veprojnë në pajtim me aktvendimin e inspektorëve të autorizuar dhe nuk i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar të përcaktuara me aktvendim, inspektori i autorizuar do të parashtrijë Kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para organit kompetent.

(4) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar të mjedisit jetësor të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe të inspektorëve komunalë të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, mund të paraqitet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimin të aktvendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(5) Për kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori i autorizuar ka të drejtë për marrjen edhe të masave tjera të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor dhe Ligjin për menaxhim me hedhurina.

Neni 49

Fushëveprimi i mbikëqyrjes së inspektorit shtetëror të tregut

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i vet inspektori shtetëror i tregut, ka të drejtë:

- 1) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë, nëse parashtrohet udhëzim në pajtim me nenin 7 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 2) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë, nëse bateritë dhe akumulatorët e hedhur që janë të lëshuar në treg janë të shënuar në pajtim me nenin 10 të këtij ligji (neni 10);
- 3) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë, nëse bateritë dhe e hedhur që janë të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj, që kanë të bëjnë me përbërjen e baterive dhe akumulatorëve dhe mënyrën e shënimit të tyre (neni 11);
- 4) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë, nëse bateritë dhe akumulatorët që janë të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë rrjedhin nga personat juridikë që janë të regjistruar për këtë në pajtim me nenin 12 të këtij ligji;
- 5) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë, nëse tregtari i pranon bateritë dhe akumulatorët e hedhur të bartshëm të dorëzuar nga ana e shfrytëzuesve të fundit në pajtim me nenin 16 të këtij ligji;
- 6) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë, nëse tregtari ka vendosur enë përkatëse në pikat për grumbullim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur (neni 17 paragrafi (2)) dhe
- 7) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse tregtari vendosë njoftim në të cilin do të shënohen informata për shfrytëzuesin e fundit për mënyrën e grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në pikat për grumbullim në kuadër të lokalit të tij afarist (neni 17 paragrafi (4)).

(2) Nëse inspektori shtetëror i tregut gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese konstaton se:

- 1) bateritë dhe akumulatorët nuk janë të shënuara në pajtim me nenin 10 të këtij ligji (neni 10);
- 2) bateritë dhe akumulatorët që janë të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj të cilat kanë të bëjnë me përbërjen e baterive dhe akumulatorëve dhe mënyrën e shënimit të tyre (neni 11) dhe
- 3) bateritë dhe akumulatorët që janë të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë rrjedhin nga persona juridikë që nuk janë të regjistruar për këtë në pajtim me nenin 12 të këtij ligji; përkohësisht do t'i konfiskoje bateritë dhe akumulatorët me të cilët bëhet tregti.

(3) Për konfiskimin e kryer të baterive dhe akumulatorëve nga paragrafi (2) i këtij neni inspektori shtetëror i tregut jep vërtetim.

(4) Për sendet e marra nga paragrafi (2) pika 3 e këtij neni, Inspektorati Shtetëror i Tregut vepron në pajtim me Ligjin për menaxhim me pronën e konfiskuar, dobinë pronësore dhe sendet e konfiskuara në procedurë penale dhe kundërvajtëse.

(4) Në kryerjen e punëve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, Inspektorati Shtetëror i Tregut kanë të drejtë për marrjen edhe të masave tjera të përcaktuara me Ligjin për inspektoratin e tregut, Ligjin për mjedisin jetësor dhe Ligjin për menaxhim me hedhurina. ²

Neni 50

Miratimi i aktvendimeve të inspektorit shtetëror të tregut

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorati shtetëror i tregut, personat juridikë dhe fizikë me aktvendim:

- 1) do t'i obligojë të parashtrojnë udhëzim në pajtim me nenin 7 paragrafi (2) të këtij neni;
- 2) do t'i obligojnë t'i tërheqin nga tregu bateritë dhe akumulatorët që kanë prani të metaleve të rënda në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji;
- 3) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 15 ditë, nëse bateritë dhe akumulatorët që janë të lëshuar në treg nuk janë të shënuar në pajtim me nenin 10 të këtij ligji dhe do t'i obligojë që në afat

prej 15 ditëve t'i mënjanojnë pasojat;

4) do t'i obligojë që t'i tërheqin nga tregu bateritë dhe akumulatorët që nuk janë të shënuar në pajtim me nenin 10 të këtij ligji;

5) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 15 ditë, nëse bateritë dhe akumulatorët që janë të lëshuar në treg nuk i përmbushin kushtet nga neni 11 i këtij ligji dhe do të përcaktoj afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë që t'i mënjanojnë pasojat;

6) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 30 ditë, nëse konstaton se bateritë dhe akumulatorët që janë të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë rrjedhin nga persona juridikë që janë të regjistruar për këtë në pajtim me nenin 12 të këtij ligji dhe do të përcaktoj afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë që t'i mënjanojnë pasojat;

7) do t'i obligojë që t'i realizojnë obligimet nga neni 16 i këtij ligji;

8) do t'i obligojë që të vendosin enë përkatëse në pikat për grumbullim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur (neni 17 paragrafi (2)) dhe

9) do t'i obligojë të vendosin njoftim në të cilin do të shënohen informata për shfrytëzuesin e fundit, për mënyrën e grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në pikat për grumbullim në kuadër të lokalit të vet afarist (neni 17 paragrafi (4)).

(2) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror të tregut, mund të paraqitet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit, në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Neni 51

Zbatimi i dispozitave nga ligjet tjera në mbikëqyrjen inspektuese

Inspektorët shtetërorë të mjedisit jetësor, inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor, inspektorët e komunaleve të komunave, mbikëqyrjen inspektuese në sferën e menaxhimit me bateritë dhe akumulatorët dhe hedhurinat nga bateritë dhe akumulatorët e kryejnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Ligjit për menaxhim me hedhurina, Ligjit për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligjit për mjedisin jetësor.

Neni 52

Procedura për edukim

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, përkatësisht organi tjetër që e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese konstaton se është kryer parregullsi nga nenet 53, 53 paragrafi (1) pikat 2, 6, 7 dhe 8, 58 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7 dhe 59 të këtij ligji, është i obliguar që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së përcaktuar në afatin e caktuar dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose subjektit ku është përcaktuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, përkatësisht organi tjetër i administratës shtetërore i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të përcaktuara të njëjta ose të njëllojta për një ose më shumë subjekte.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet

edukimi, nuk paraqitet për edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(6) Nëse personi ose subjekti mbi të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, përkatësisht organi tjetër i administratës shtetërore që e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese përcakton se janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, përkatësisht organi tjetër i administratës shtetërore që e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashton kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para Komisionit për Kundërvajtje.

(9) Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, përkatësisht organi tjetër i administratës shtetërore që e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese mban evidencë unike për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

VII. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 53

Sanksione për kundërvajtje për prodhuesit

(1) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit i cili është person juridik për kundërvajtje, nëse:

- 1) nuk vepron në pajtim me nenin 8 të këtij ligji, nëse:
- 2) nuk regjistrohet kur për herë të parë lëshon në treg ose importon si shfrytëzues i fundit në Republikën e Maqedonisë bateri dhe akumulatorë (neni 12 paragrafi (1)) dhe
- 3) nuk e informon publikun në pajtim me nenin 18 paragrafi (5) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

3) Gjobë në shumë prej 200 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit i cili është person fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 54

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit i cili është person juridik për kundërvajtje, nëse:

- 1) nuk i dizajnojnë pajisjet në mënyrë që do të mundësojë që shfrytëzuesi i fundit lehtë t'i mënjanojë bateritë dhe akumulatorët e hedhur (neni 7 paragrafi (1));
- 2) nuk parashtrojnë udhëzim në pajtim me nenin 7 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 3) nuk i shënon bateritë, akumulatorët, si dhe paketimet e baterive që i lëshon në treg në Republikën e Maqedonisë në pajtim me nenin 10 paragrafi (1);
- 4) nuk i shënon edhe me simbol kimik bateritë, akumulatorët dhe bateritë në formë të pullës që përmbajnë më shumë se 0,0005 % zhivë, më shumë se 0,002 % dhe më shumë se 0,004 plumb në pajtim me nenin 10 paragrafi (2);

5) shenjat nga paragrafët (1) dhe (2) nga neni 10 i këtij ligji nuk janë të dukshme qartësisht, të lexueshme dhe të paraqitura në mënyrë të pashlyeshme (neni 10 paragrafi (3));

6) nuk vepron në pajtim me nenin 16 paragrafi (2) të këtij ligji;

7) nuk siguron grumbullim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur që ia ka shitur poseduesit ose tregtarit, e të cilat ata i kanë grumbulluar në afat prej 48 orëve nga momenti kur poseduesi ose tregtari ka kërkuar t'i dorëzojë bateritë dhe akumulatorët e hedhur të grumbulluar (neni 19 paragrafi (1));

8) nuk ka siguruar enë përkatëse për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur (neni 19 paragrafi (2));

9) grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të automjeteve dhe industrialë ia ka ngarkuar personit të tretë i cili nuk posedon leje për grumbullimin e hedhurinave të rrezikshme të marrë në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina (neni 19 paragrafi (4)) dhe

10) nuk mban evidencë në pajtim me nenin 30 paragrafi (6) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 900 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 600 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit i cili është person fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragrafi (1) pikat 9 dhe 10 të këtij neni, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje në Sferën e Mjedisit Jetësor i Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për Kundërvajtje) mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë së veçantë nga e cila rrjedh kundërvajtja në kohëzgjatje prej së paku tre ditë deri më së shumti 30 ditë.

(5) Personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (2) dhe personit fizik nga paragrafi (3) i këtij neni, Komisioni për Kundërvajtje mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e detyrës nga e cila rrjedh kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej më së paku tre ditë deri më së shumti 15 ditë.

Neni 55

(1) Gjobë në shumë prej 6.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit i cili është person juridik për kundërvajtje, nëse:

1) nuk siguron grumbullim, përpunim dhe riciklim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur nga shfrytëzuesi i fundit pavarësisht nga përbërja e tyre kimike, origjina ose data kur për herë të parë janë të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë (neni 18 paragrafi (1));

2) nuk posedon leje në pajtim me nenin 23 të këtij ligji, e as ka marrëveshje të lidhur për marrjen e obligimeve për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur me vepruesin kolektiv (neni 21 paragrafi (1)) dhe

3) nuk i përmbushë obligimet e përcaktuara në marrëveshjet vullnetare (neni 37).

(2) Gjobë në shumë prej 900 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit i cili është person fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni për Kundërvajtje mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë së veçantë nga e cila rrjedh kundërvajtja në kohëzgjatje prej së paku tre ditë deri më së shumti 30 ditë.

(5) Personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (2) dhe personit fizik nga paragrafi (3) i këtij neni, Komisioni për Kundërvajtje mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e detyrës nga e cila rrjedh kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku tre ditë deri më së shumti 15 ditë.

Neni 56

Sanksionet për kundërvajtje për prodhuesin e vogël

(1) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit të vogël i cili është person juridik për kundërvajtje, nëse:

1) nuk mban evidencë në pajtim me nenin 30 të këtij ligji (neni 20 paragrafi (3)).

(2) Gjobë në shumë prej 700 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit të vogël i cili është person fizik për veprimin nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 57

(1) Gjobë në shumë prej 3.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit të vogël i cili është person juridik për kundërvajtje, nëse:

1) ka parashtruar të dhëna të rrejshme dhe ka mbajtur evidencë të rrejshme me qëllim që të paraqitet si prodhues i vogël dhe të përjashtohet nga obligimi në pajtim me nenin 34 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimin nga paragrafi (4) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 900 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit të vogël i cili është person fizik për veprimin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni për Kundërvajtje mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë së veçantë nga e cila rrjedh kundërvajtja në kohëzgjatje prej së paku tre ditë deri më së shumti 30 ditë.

(5) Personit përgjegjës në personit juridik nga paragrafi (2) dhe personit fizik nga paragrafi (3) i këtij neni, Komisioni për Kundërvajtje mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e detyrës nga e cila rrejdhtë kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku tre ditë deri më së shumti 15 ditë.

Neni 58

Sanksionet për kundërvajtje për poseduesit dhe tregtarët

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit ose tregtarit i cili është person juridik për kundërvajtje, nëse:

1) refuzon t'i pranojë bateritë dhe akumulatorët e hedhur të bartshëm nga ana e shfrytëzuesit të fundit ose për këtë kërkon si kompenzim blerjen e baterive dhe/ose akumulatorëve të rinj ose arkëton kompenzim për kthimin (neni 16 paragrafi (1));

2) poseduesi i cili punon me bateri industriale dhe automobilistike dhe

akumulatorëve të prodhuesit refuzon pa pagesë t'i merr mbrapa bateritë dhe akumulatorët industrial dhe automobilistik të nxjerrë jashtë përdorimit nga shfrytëzuesit e fundit, pa marrë parasysh përbërjen e tyre kimike dhe prejardhjen (neni 16 paragrafi (2)) dhe

3) nuk vendosë enë adekuate në pajtim me nenin 17 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji;

4) nuk i merr bateritë dhe akumulatorët e hedhur të bartshëm që i ka në programin e vet të shitjes pa kompensim ose për këtë kërkon si kompensim blerje nga shfrytëzuesi i fundit, pa marrë parasysh prodhuesin, duke përfshirë edhe bateritë dhe akumulatorët e hedhur që janë pjesë përbërëse e pajisjeve që shiten ose servisohen (neni 17 paragrafi (3));

5) nuk vendosë njoftim në vend të dukshëm në të cilin do të shënohen informata për shfrytëzuesin e fundit për mënyrën e grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në vendet për grumbullim në kuadër të lokalit të vet afarist (neni 17 paragrafi (4));

6) bateritë dhe akumulatorët e hedhur të grumbulluar nuk ia dorëzon personit të autorizuar për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur (neni 17 paragrafi (5));

7) kur është e mbushur ena me bateri dhe akumulatorë të hedhur nuk e njofton vepruesin kolektiv ose vepruesin e pavarur me qëllim që të vijë dhe t'i marrë bateritë dhe akumulatorët e hedhur të grumbulluar (neni 28 paragrafi 3)) dhe

8) nuk vepron në pajtim me nenin 33 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 900 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 700 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet poseduesit dhe tregtarit i cili është person fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 59

Sanksionet për kundërvajtje për shfrytëzuesin e fundit

(1) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet shfrytëzuesit të fundit si operator ekonomik, i cili është person juridik për kundërvajtje, nëse:

1) i lë ose i dorëzon bateritë dhe akumulatorët e hedhur në vende të shënuara për grumbullimin dhe seleksionimin e hedhurinave të komunalieve nga amvisëritë ose të llojit tjetër të hedhurinave (neni 14);

2) nuk vepron me bateritë dhe akumulatorët e hedhur në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) të këtij ligji dhe

3) bateritë dhe akumulatorët e hedhur që i krijojnë nuk i lënë në vende të caktuara për atë dedikim ose nuk ua dorëzojnë personave juridikë ose fizikë të cilët posedojnë leje për veprim me hedhurina (neni 15 paragrafi (4));

(2) Gjobë në shumë prej 400 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 200 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet shfrytëzuesit të fundit si operator ekonomik i cili është person fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 60

Sanksionet për kundërvajtje për personat fizikë

(1) Gjobë në shumë prej 60 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet në vendin e ngjarjes personit fizik i cili nuk është operator ekonomik për veprimet për kundërvajtje, nëse:

- 1) i lënë ose i dorëzon bateritë dhe akumulatorët e hedhur në vende të shënuara për grumbullimin dhe seleksionimin e hedhurinave të komunalieve nga amvisëritë ose të llojit tjetër të hedhurinave (neni 14);
- 2) nuk i ruan ndaras, grumbullon dhe i le ndaras bateritë dhe akumulatorët e hedhur nga hedhurinat e komunalieve dhe llojet tjera të hedhurinave (neni 15 paragrafi (1));
- 3) bateritë dhe akumulatorët e hedhur që i krijojnë nuk i lënë në vende të caktuara për atë dedikim ose nuk ua dorëzojnë personave juridikë ose fizikë të cilët posedojnë leje për veprim me hedhurina (neni 15 paragrafi (3));
- 4) nuk ia dorëzon bateritë dhe akumulatorët e hedhur industrialë prodhuesit nga i cili i ka marrë ose vepruesit kolektiv për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur (neni 15 paragrafi (4)) dhe
- 5) nuk i grumbullon ndaras sipas llojit në enë të shënuara të veçanta (neni 15 paragrafi (6));

(2) Për kundërvajtjet nga ky nen inspektorët shtetërorë të mjedisit jetësor, inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor, inspektorët e komunalieve të komunave, të komunës në qytetit të Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, gjohën nga paragrafi (1) i këtij neni do ta shqiptojnë me dorëzimin e ftesës për arkëtim të gjohës të cilën kryerësi është i obliguar ta paguajë në afat prej tetë ditësh.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton formën dhe përmbajtjen e ftesës për arkëtimin e gjohës nga paragrafi (2) i këtij neni.

Neni 61

Sanksionet për kundërvajtje për vepruesin e pavarur

(1) Gjohë në shumë prej 4.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit të pavarur i cili është person juridik për kundërvajtje, nëse:

- 1) nuk vepron në pajtim me nenin 21 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 2) kryerjen e punëve nuk ua ka ngarkuar personave të tretë (neni 21 paragrafi (4));
- 3) nuk ka siguruar marrëveshje për marrjen e obligimeve për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur me prodhuesit në pajtim me nenin 22 paragrafi (1);
- 4) nuk e ka njoftuar organin profesional për ndryshimet e krijuara (neni 22 paragrafi (4));
- 5) prodhuesve me të cilët ka lidhur marrëveshje për marrjen e obligimit për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur nuk u jep vërtetim për lirim nga pagesa e kompensimit nga neni 39 i këtij ligji (neni 22 paragrafi (8));
- 6) nuk i ka siguruar kushtet e përcaktuara në nenin 25 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 7) në program nuk ka siguruar masa për poseduesin ose tregtarin që të mos refuzojnë t'i marrin mbrapa falas bateritë dhe akumulatorët e hedhur industrialë nga shfrytëzuesit e fundit, pa marrë parasysh përbërjen e tyre kimike dhe origjinën (neni 25 paragrafi (3));
- 8) nuk ndërmerr aktivitete për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve nga poseduesit dhe shfrytëzuesit e fundit ose nga vendet për grumbullim të kapshme në afërsi të tyre, vendet e shitjes, ose vendet tjera të kapshme ku krijohet ky lloj i hedhurinave, nëse grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur nuk e ka organizuar bashkë me sistemin për veprim me automjetet e përdorura (neni 25 paragrafi (4));
- 9) nuk siguron masa me të cilat pranimit i baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve nga automjetet personale, jo komerciale, të mos i nënshtrohet asnjë shpenzimi për shfrytëzuesit e fundit, kur ato i lënë bateritë dhe akumulatorët e hedhur dhe as, t'u krijojë kurrfarë obligimi për blerjen e baterive dhe akumulatorëve të rinj (neni 25 paragrafi (5));

- 10) grumbullimin, trajtimin, riciklimin dhe mënjanimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur, nuk ua ngarkon vetëm personave fizikë dhe juridikë të cilët posedojnë leje përkatëse për veprim me hedhurina në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina dhe/ose Ligjin për mjedisin jetësor (neni 25 paragrafi (7));
- 11) grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur industrialë nuk ia ngarkon që ta kryejë person tjetër juridik ose person fizik i cili posedon leje për grumbullimin e hedhurinave të rrezikshme në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina (neni 25 paragrafi (8));
- 12) nuk ka siguruar një vend për grumbullim ose qendër ekuivalente me 1000 banorë për bateritë dhe akumulatorët e hedhur të bartshëm (neni 25 paragrafi (10));
- 13) nuk ka siguruar një vend për grumbullim ose qendër ekuivalente me 5000 banorë për bateritë dhe akumulatorët e hedhur të automjeteve (neni 25 paragrafi (11));
- 14) nuk ka marrë masa me të cilat siguron që trajtimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur të grumbulluar të kryhet në pajtim me nenin 26 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji;
- 15) bashkë me raportet nga neni 30 i këtij ligji, nuk dorëzon edhe raport për shkallën e efikasitetit të riciklimit që arrihet në çdo vit kalendarik (neni 26 paragrafi (5));
- 16) nuk vepron në pajtim me nenin 26 paragrafi (11) të këtij ligji;
- 17) nuk siguron që vendet për grumbullim të rregullohen në atë mënyrë që të mundësojë që shfrytëzuesit e fundit t'i lënë bateritë dhe akumulatorët e hedhur, si dhe nuk siguron marrje të rregullt të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në afat prej 48 orëve nga momenti i marrjes së njoftimit nga poseduesi ose tregtari se enët për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur janë mbushur (neni 27 paragrafi (1));
- 18) në sistemin e vet nuk siguron vendosje të posterëve ose mjeteve tjera për informim me të cilat do ta informojë publikun dhe shfrytëzuesit e fundit për veprimin me bateritë dhe akumulatorët e hedhur (neni 27 paragrafi (2));
- 19) nuk vepron në pajtim me nenin 27 paragrafi (3) dhe
- 20) nuk vepron në pajtim me nenin 30 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në vepruesin e pavarur me bateritë dhe akumulatorët e hedhur për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit të pavarur me bateritë dhe akumulatorët e hedhur i cili është person fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragrafi (1) pikat 2, 3, 11 dhe 12, të këtij neni, gjykata kompetente mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë së veçantë nga e cila rrjedh kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muaj deri më së shumti pesë vjet.

(5) Personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (2) dhe personit fizik nga paragrafi (3) i këtij neni, gjykata kompetente mund t'u shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e detyrës nga e cila rrjedh kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku një viti deri më së shumti pesë vjet.

Neni 62

(1) Gjobë në shumë prej 6.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit të pavarur i cili është person juridik për kundërvajtje, nëse:

- 1) nuk i realizon të gjitha obligimet që në pajtim me këtë ligj janë të përcaktuara si detyrë për vepruesin kolektiv dhe për prodhuesin (neni 23 paragrafi (4));
- 2) nuk i parashtron raportet në pajtim me nenin 30 të këtij ligji (neni 23 paragrafi (5));
- 3) bashkë me raportet nga neni 30 i këtij ligji, nuk parashtron edhe raport

për shkallën e efikasitetit të riciklimit që arrihet në çdo vit kalendarik nga paragrafi (3) i nenit 26 të këtij ligji (neni 26 paragrafi (5));
4) nuk vepron në pajtim me nenin 26 paragrafi (9) të këtij ligji;
5) nuk vepron në pajtim me nenin 26 paragrafi (11) të këtij ligji;
6) nuk siguron që vendet për grumbullim të rregullohen në atë mënyrë që të mundësojë që shfrytëzuesit e fundit t'i lënë bateritë dhe akumulatorët e hedhur, si dhe të sigurojë marrje të rregullt të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në afat prej 48 orëve nga momenti i marrjes së njoftimit nga poseduesi ose tregtari se enët për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur janë mbushur (neni 27 paragrafi (1)) dhe
7) raportin vjetor nga paragrafi (1) i nenit 30 të këtij ligji nuk e parashton për bateritë dhe akumulatorët e hedhur që vetë i ka lëshuar në treg për herë të parë në Republikën e Maqedonisë (neni 30 paragrafi (2));

(2) Gjobë në shumë prej 1 200 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit të pavarur i cili është person fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 63

(1) Gjobë në shumë prej 9.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit të pavarur me bateritë dhe akumulatorët e hedhur i cili është person juridik për kundërvajtje, nëse:

1) nuk i përmbushë obligimet e përcaktuara në marrëveshjet vullnetare (neni 37).

(2) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit të pavarur i cili është person fizik për kundërvajtje, për veprimin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, gjykata kompetente mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë së veçantë nga e cila rrjedh kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muaj deri më së shumti pesë vjet.

(5) Personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (2) dhe personit fizik nga paragrafi (3) i këtij neni, gjykata kompetente mund t'u shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e detyrës nga e cila rrjedh kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku një vit deri më së shumti pesë vjet.

Neni 64

(1) Gjobë në shumë prej 15.000 deri në 25.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit të pavarur i cili është person juridik, për kundërvajtje nëse:

1) nuk parashton raport vjetor në pajtim me nenin 31 të këtij ligji;

2) nuk posedon leje në pajtim me nenin 23 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji dhe

3) parashton raporte me të dhëna të pasakta me qëllim që të konstatohet se janë arritur qëllimet nga neni 35 i këtij ligji;

(2) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 4.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me

denarë do t'i shqiptohet vepruesit të pavarur i cili është person fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, gjykata kompetente mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë së veçantë nga e cila rrjedh kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muaj deri më së shumti pesë vjet.

(5) Personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (2) dhe personit fizik nga paragrafi (3) i këtij neni, gjykata kompetente mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e detyrës nga e cila rrjedh kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku një vit deri më së shumti pesë vjet.

Neni 65

Sanksione për kundërvajtje për vepruesin kolektiv

(1) Gjohë në shumë prej 9 000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit kolektiv për kundërvajtje, nëse:

- 1) nuk vepron në pajtim me nenin 21 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 2) kryerjen e punëve nuk ua ka ngarkuar personave të tretë (neni 21 paragrafi (4));
- 3) nuk ka siguruar marrëveshje për marrjen e obligimeve për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur me prodhuesit në pajtim me nenin 22 paragrafi (1);
- 4) nuk e ka njoftuar organin profesional për ndryshimet e krijuara (neni 22 paragrafi (4));
- 5) prodhuesve me të cilët ka lidhur marrëveshje për marrjen e obligimit për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur nuk u jep vërtetim për lirim nga pagesa e kompensimit nga neni 39 i këtij ligji (neni 22 paragrafi (8));
- 6) nuk i ka siguruar kushtet e përcaktuara në nenin 25 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 7) në program nuk ka siguruar masa për poseduesin ose tregtarin që të mos refuzojnë t'i marrin mbrapa falas bateritë dhe akumulatorët e hedhur industrialë nga shfrytëzuesit e fundit, pa marrë parasysh përbërjen e tyre kimike dhe origjinën (neni 25 paragrafi (3));
- 8) nuk ndërmerr aktivitete për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve nga shfrytëzuesit e fundit ose nga vendet për grumbullim të kapshme në afërsi të tyre, vendet e shitjes, ose vendet tjera të kapshme ku krijohet ky lloj i hedhurinave, nëse grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur nuk e ka organizuar bashkë me sistemin për veprim me automjetet e përdorura (neni 25 paragrafi (4));
- 9) nuk siguron masa me të cilat pranimit i baterive dhe akumulatorëve të hedhur të automjeteve nga automjetet personale, jo komerciale, të mos i nënshtrohet asnjë shpenzimi për shfrytëzuesit e fundit kur ato i lënë bateritë dhe akumulatorët e hedhur dhe as, t'u krijojë kurrfarë obligimi për blerjen e baterive ose akumulatorëve të rinj (neni 25 paragrafi (5));
- 10) grumbullimin, trajtimin, riciklimin dhe mënjanimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur, nuk ua ngarkon vetëm personave fizikë dhe juridikë të cilët posedojnë leje përkatëse për veprim me hedhurina në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina dhe/ose Ligjin për mjedisin jetësor (neni 25 paragrafi (7));
- 11) grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur industrialë nuk ia ngarkon që ta kryejë personi tjetër juridik ose personi fizik i cili posedon leje për grumbullimin e hedhurinave të rrezikshme në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina (neni 25 paragrafi (8));
- 12) nuk ka siguruar një vend për grumbullim ose qendër ekuivalente me 1000 banorë për bateritë dhe akumulatorët e hedhur të bartshëm (neni 25 paragrafi (10));
- 13) nuk ka siguruar një vend për grumbullim ose qendër ekuivalente me 5000 banorë për bateritë dhe akumulatorët e hedhur të automjeteve (neni 25 paragrafi (11));

- 14) nuk ka marrë masa me të cilat siguron që trajtimi i baterive dhe akumulatorëve të hedhur të grumbulluar të kryhet në pajtim me nenin 26 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji;
- 15) bashkë me raportet nga neni 30 i këtij ligji, nuk dorëzon edhe raport për shkallën e efikasitetit të riciklimit që arrihet në çdo vit kalendarik (neni 26 paragrafi (5));
- 16) nuk vepron në pajtim me nenin 26 paragrafi (11) të këtij ligji;
- 17) nuk siguron që vendet për grumbullim të rregullohen në atë mënyrë që të mundësojë që shfrytëzuesit e fundit t'i lënë bateritë dhe akumulatorët e hedhur, si dhe nuk siguron marrje të rregullt të baterive dhe akumulatorëve të hedhur në afat prej 48 orëve nga momenti i marrjes së njoftimit nga poseduesi ose tregtari se enët për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur janë mbushur (neni 27 paragrafi (1));
- 18) në sistemin e vet nuk siguron vendosje të posterëve ose mjeteve tjera për informim me të cilat do ta informojë publikun dhe shfrytëzuesit e fundit për veprimin me bateritë dhe akumulatorët e hedhur (neni 27 paragrafi (2));
- 19) nuk vepron në pajtim me nenin 27 paragrafi (3) dhe
- 20) nuk vepron në pajtim me nenin 30 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në vepruesin kolektiv për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 66

(1) Gjobë në shumë prej 20.000 deri në 35.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit kolektiv për kundërvajtje, nëse:

- 1) nuk dorëzon raport vjetor në pajtim me nenin 31 të këtij ligji;
- 2) nuk posedon leje në pajtim me nenin 22 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 3) dorëzon raporte me të dhëna të pasakta me qëllim që të konstatohet se janë arritur qëllimet nga neni 35 i këtij ligji dhe
- 4) nuk i përmbush obligimet e përcaktuara në marrëveshjet vullnetare (neni 37).

(2) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në vepruesin kolektiv për veprimet nga paragrafi (3) i këtij neni.

(3) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, gjykata kompetente mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë së veçantë nga e cila rrjedh kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muaj deri më së shumti pesë vjet.

(4) Personit përgjegjës në vepruesin kolektiv nga paragrafi (2) i këtij neni, gjykata kompetente mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e detyrës nga e cila rrjedh kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku një vit deri më së shumti pesë vjet.

Neni 67

Sanksionet për kundërvajtje për personin juridik i cili nuk është operator ekonomik

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili nuk është operator ekonomik, nëse:

- 1) mënjanon bateri dhe akumulatorë të hedhur në plehërishta (neni 9 paragrafi (1));
- 2) djeg bateri dhe akumulatorë të hedhur të automjeteve dhe industrialë (neni 9 paragrafi (2));
- 3) bateritë dhe akumulatorët e hedhur i le ose i dorëzon në vende të shënuara për grumbullimin dhe selektimin e hedhurinave të komunalieve nga amvisëritë ose të llojit tjetër të hedhurinave (neni 14);
- 4) nuk vepron me bateritë dhe akumulatorët e hedhur në pajtim me nenin

15 paragrafi (2) të këtij ligji;

5) bateritë dhe akumulatorët e hedhur nuk ia dorëzon prodhuesit nga i cili i ka marrë ose vepruesit kolektiv për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur nga neni 22 i këtij ligji (neni 15 paragrafi (4));

6) personi juridik dhe fizik i cili për vepruesin kolektiv ose për vepruesin e pavarur kryen grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur dhe nuk përpilon dhe dorëzon raporte për sasi të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të grumbulluar në formular të veçantë (neni 31 paragrafi (1));

7) personi juridik dhe fizik i cili për vepruesin kolektiv ose për vepruesin e pavarur kryen përpunimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur dhe nuk përpilon dhe dorëzon raport për sasi të baterive dhe akumulatorëve të hedhur të marrë dhe të përpunuar ose të ricikluar në formular të veçantë (neni 31 paragrafi (3)) dhe

8) personi juridik dhe fizik i cili kryen trajtim të baterive dhe akumulatorëve të hedhur nuk përpilon dhe nuk dorëzon raport për shkallën e efikasitetit për riciklimin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur e cila arrihet në çdo vit kalendarik, si dhe për atë nëse është përmbushur efikasiteti i riciklimit në pajtim me nenin 26 të këtij ligji (neni 31 paragrafi (4));

(2) Gjohë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 68

Procedura për barazim dhe ndërmjetësim

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58 dhe 66 të këtij ligji, organet për mbikëqyrje inspektuese nga neni 43 i këtij ligji janë të obliguar kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për barazim para se të parashtrajnë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 60, 61, 62, 63, 64 dhe 65 të këtij ligji, organet për mbikëqyrje inspektuese nga neni 43 i këtij ligji kryerësit të kundërvajtjes do t'i propozojnë procedurë për ndërmjetësim para se të parashtrajnë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.

(3) Në rastet në të cilat është arritur pajtim për barazim, gjoha e kryerësit mund të zvogëlohet më së shumti për një gjysmë nga maksimumi i gjohës së përcaktuar për kundërvajtje.

(4) Procedurat për barazim dhe ndërmjetësim udhëhiqen në pajtim me dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor dhe Ligjit për kundërvajtje.

Neni 69

Udhëheqja e procedurës për kundërvajtje

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60 dhe 67 të këtij ligji procedurë për kundërvajtje udhëheqë dhe sanksion për kundërvajtje shqipton Komisioni për Kundërvajtje.

(2) Procedura para Komisionit për Kundërvajtje udhëhiqet në pajtim me dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor.

(3) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 61, 62, 63, 64, 65 dhe 66 të këtij ligji procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 70

Afatet për zbatim

(1) Prodhuesit ekzistues të cilët lëshojnë në treg ose importojnë si shfrytëzues të fundit në Republikën e Maqedonisë bateri dhe akumulatorë të hedhur në pajtim me nenin 12 të këtij ligji, janë të obliguar që të regjistrohen më së voni deri më 31 dhjetor 2011.

(2) Prodhuesi evidencën nga neni 30 paragrafi (6) është i obliguar që të fillojë ta mbajë nga 1 janari 2011.

(3) Njoftimin e parë nga neni 30 paragrafi (6) të këtij ligji për llojin dhe sasinë e baterive dhe akumulatorëve që prodhuesi i ka lëshuar në treg dhe i ka importuar në Republikën e Maqedonisë gjatë një viti, është i obliguar ta dorëzojë më së voni deri më 31 mars 2012.

(4) Obligimet për shënimin e baterive dhe akumulatorëve nga neni 10 i këtij ligji, do të zbatohen nga 1 janari 2012.

(5) Ndalimi për import të baterive dhe akumulatorëve nga neni 13 i këtij ligji, fillon të zbatohet nga 1 janari 2012.

(6) Obligimi nga neni 17 për vendosjen e enëve dhe sigurimin e lokalit për lënien e baterive dhe akumulatorëve të hedhur, si dhe për vendosjen e njoftimeve për poseduesin dhe tregtarët në mjedise urbane, do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2015, përkatësisht për poseduesin dhe tregtarët në mjedise rurale nga 1 janari 2017.

(7) Obligimet për arritjen e shkallës së efikasitetit të riciklimit nga neni 25 paragrafi (3) i këtij ligji do të arrijë më së voni deri në dhjetor 2016.

(8) Programi për menaxhim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur nga neni 36 i këtij ligji, do të miratohet më së voni deri më 31 dhjetor 2011.

(9) Raporti i parë nga neni 38 paragrafi (3) të këtij ligji, publikohet më së voni deri më 30 maj 2013.

(10) Prodhuesit në pajtim me obligimet nga neni 18 i këtij ligji janë të detyruar që të bashkohen nëpërmjet themelimit të vepruesit kolektiv dhe/ose lidhjes së marrëveshjes me vepruesin kolektiv për veprim me bateritë dhe akumulatorët e hedhur ose të regjistrohen si veprues të pavarur me hedhurinat nga bateritë dhe akumulatorët, më së voni deri më 31 dhjetor 2011.

Neni 71

Zbatimi i prolonguar

Dispozitat nga neni 38 paragrafi (7) të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen me ditën e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

Neni 72

Miratimi i rregullave më të përafërta

Rregullat më të përafërta për zbatimin e këtij ligji do të miratohen më së voni deri më 31 nëntor 2011.

Neni 73

Zbatimi i kompensimeve dhe arritja e qëllimeve nacionale

(1) Kompensimi nga neni 39 i këtij ligji do të fillojë të zbatohet nga 1

janari 2012.

(2) Për vitin 2013 do të konsiderohet se janë arritur qëllimet nacionale nga neni 35 i këtij ligji, nëse grumbullohen bateri dhe akumulatorë të hedhur të bartshëm në sasi prej 5 % nga pesha e baterive dhe akumulatorëve të bartshëm që janë të lëshuar në treg në territorin e Republikës së Maqedonisë nga viti rrjedhës.

(3) Për vitin 2014 do të konsiderohet se janë arritur qëllimet nacionale nga neni 35 i këtij ligji, nëse grumbullohen bateri dhe akumulatorë të hedhur në sasi prej 12,5 % të baterive dhe akumulatorëve që janë të lëshuar në treg në territorin e Republikës së Maqedonisë nga viti rrjedhës.

(4) Për vitin 2015 do të konsiderohet se janë arritur qëllimet nacionale nga neni 35 i këtij ligji, nëse grumbullohen bateri dhe akumulatorë të hedhur në sasi prej 20 % të baterive dhe akumulatorëve që janë të lëshuar në treg në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 74

Shfuqizimi

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, shfuqizohen dispozitat nga nenet 6 paragrafi (1) pikat 13 dhe 14, 70 dhe 130 paragrafi (1) pika 22 nga Ligji për menaxhim me hedhurina ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 68/2004, 71/2004, 107/2007, 102/2008 dhe 143/2008).

Neni 75

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2011.

DISPOZITA NGA LIGJE TË TJERA

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me bateri dhe akumulator dhe bateri dhe akumulator dhe bateri dhe akumulator të hedhur ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/2011):

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

Ligj për plotësimin e Ligjit për menaxhim me bateri dhe akumulator dhe bateri dhe akumulator dhe bateri dhe akumulator të hedhur ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 148/2011):

Neni 6

Aktet nënligjore nga nenet 1, 2, 4 dhe 5 të këtij ligji miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Pas miratimit të akteve nënligjore nga nenet 1, 2, 4 dhe 5 të këtij ligji, të njëjtat menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohen në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

Ligj për plotësimin e Ligjit për menaxhim me bateri dhe akumulator dhe bateri dhe akumulator dhe bateri dhe

akumulator të hedhur ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 148/2011):

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozitave nga nenet 1 dhe 3 të këtij ligji që do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelim të Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

Ligj për plotësimin e Ligjit për menaxhim me bateri dhe akumulatorë dhe bateri dhe akumulatorë të hedhur ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/2012):

Neni 6

Dispozita nga neni 39-a paragrafi (3) e përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji, do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me bateri dhe akumulatorë dhe bateri dhe akumulatorë të hedhur ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“, ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 maji 2014.